

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË KAVAJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Kavajë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 107, datë 31.08.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 226/9 datë 31.08.2015, i ka rekomanduar z. Elvis Rroshi, Kryetar i Bashkisë Kavajë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **vlerën 30,003,092 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, si më poshtë:

1.Gjetje: Në verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara nga auditimi i mëparshëm, me shkresën nr.70/7 Prot, datë 29.04.2013, u konstatua se krahas punës së bërë për vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve, nuk kanë gjetur zbatim të plotë rekomandimet tona për 2 masa organizative, 7 masa disiplinore dhe 3 masa administrative. Nga shuma e rekomanduar masa për shpërblim dëmi prej 24,753,713 lekë, nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për dëmin ekonomik në prokurime për skualifikim të padrejtë 7 persona në vlerën 15,230,092 lekë, ose në masën 60%, pasi ky problem është bërë dhe objekt gjykimi në gjykatë, për të cilën ka vendim të formës prerë për pushimin e çështjes.

Rekomandimi:

1. Bashkia Kavajë të kryejë kontabilizimet për arkëtimin e vlerës 15,030,092 lekë, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9858, datë 04.10.2013 e cila ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr.16970 akti, që i përket paditësit Bashkia Kavajë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. regjistri 53114, datë 23.06.2014 me numër vendimi 3237 datë 23.07.2014 ka lënë në fuqi vendimin nr. 9858, datë 04.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpallur më datën 23.07.2014 vendim i cili është i formës prerë, si më poshtë:

a. Në vlerën 12,788,587 lekë ndaj 5 antarëve të Komisionit të vlerësimit të ofertave respektivisht: E.B, TH.D, A.M, F.K dhe D.M, pasi kanë skualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë me ofertë më të ulët, duke i shkaktuar dëm ekonomik bashkisë, në vlerën 12,788,587 lekë, në 8 tenderët me objekt:

- Rikonstruksioni i rrugës “Pal Xhumari” në vlerën 475,902 lekë, Rrugës Kosova 1,424,304 Rrugës Varrezave 1,206,472 lekë, Rrugës Josif Budo 2,878,699 lekë, Rrugë A. Stefi 97,795 lekë, Rrugës Luleve 67,498 lekë, R. Sukaj 724,147 lekë dhe objekti ngritje kati bashkia Kavajë në vlerën 5,913,770 lekë.

b. Në vlerën 2,241,505 lekë ndaj 4 antarëve të Njesisë së prokurimit respektivisht: E.A, A. L, A.H dhe B.D, në cilësinë e hartuesve të preventivit, në tenderin me objekt "Rikonstruksion dhe ngritje kati" i godinës së bashkisë, vlerën 2,241,505 lekë, për shkak se kanë rritur padrejtësisht fondin limit, në papajtueshmëri me analizat teknike për punimet e ndërtesave të Manualit 2 të miratuar me VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" .

2. Vlera e mbetur prej 5,282,861 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtimin nga 13 subjekte të taksës së ndikimit në infrastrukture, të merren masa duke i dërguar :

- urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Drejtorisë Rajonale të Transportit për mjetet dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, vendosja e barrës siguroese, bazuar në nenin 91të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”Për Procedurat tatimore”.

3. Të kërkohet në rrugë ligjore vlera e mbetur prej 6,305,928 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtimin nga 12 subjekte për punime të pakryera apo dëm ekonomik (sipas listës trajtuar në Pikën 1- Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm).

4. Të merren masa për zbatimin e detyrave të pa realizuara sipas rekomandimeve dërguar me shkresën nr.70/7 Prot, datë 29.04.2013, të rikërkua me shkresën nr. 687, datë 01.07.2013 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe trajtuar në proces verbalin nr. 44, datë 29.05.2015 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.Gjetje: IMTV Kavajë në zbatim të rekomandimeve të KLSH, ka nxjerrë vendimet e Gjobave për 3 mbikëqyrësit e punimeve në vlerën 200,000 lekë, por deri më datën 28.05.2015 nuk janë arkëtuar. Nuk është kërkuar nxjerrja e titullit të ekzekutimit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Kavajë, respektivisht, për mbikëqyrësit: P.P për shumën 100,000 lekë, Subjetin “D.....” sh.p.k. i përfaqësuar nga z. B...D për shumën 50,000 lekë dhe Subjektin “E... O” sh.p.k. i përfaqësuar nga zj. N.B për shumën 50,000 lekë .

Rekomandimi:Bashkia Kavajë të marrë masa, duke njoftuar 3 mbikëqyrësit e punimeve, të cilët nuk kanë pranuar të paguajnë në mënyrë vullnetare dhe të kërkojë në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Kavajë nxjerrjen e titullit të ekzekutimit, për gjobat e vendosura nga IMTV në vlerën prej 200,000 lekë, si më poshtë:

- Z. P.P, Vendimi nr. 23, datë 26.9.2013 të INUV Kavajë është vendosur gjoba në masën 100,000 lekë.

-Subjekti “D.....E” sh.p.k. i përfaqësuar nga z. B..D, Vendimi nr. 24, datë 26.9.2013 të INUV Kavajë është vendosur gjoba në masën 50,000 lekë.

- Subjeti “E..N sh.p.k. i përfaqësuar nga zj. N...B,Vendimi nr. 25, datë 26.9.2013 të INUV Kavajë është vendosur gjoba në masën 50,000 lekë.

3. Gjetje: Drejtoria e Taksave të Bashkisë Kavajë, nuk ka kryer një punë të mjaftueshme, për pasojë më datën 31.12.2014 janë debitorë **179 subjekte** në vlerën **16,061,213 lekë**, për taksat dhe tarifatat vendore nga e cila vlera prej 12,850,668 lekë janë detyrime të papaguara, ndërsa vlera prej 3,210,545 lekë janë interesa të llogaritura për mos pagesë në afat.Nga vlera e debitorëve 42% e tyre janë krijuar gjatë vitit 2014 ose në vlerën 5,305,180 lekë, ndërsa vlera prej 8,010,128 lekë ose 58 %, i përkasin viteve 2012-2013.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave të marrë masa për evidentimin e 179 debitorëve, kontabilizimin e detyrimeve të pa likuiduara, deri më datën 31.12.2014, të nxiren njoftim vlerësimet për taksat e papaguara dhe kamat vonesat si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën prej **16,061,213 lekë**.

Për arkëtimin e detyrimeve tatimore sugjerojmë të veprohet si më poshtë:

a-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme Kavajë (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

c-Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, dt.4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

d- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashki, të evidentojë abonentët familjarë për të cilët nuk janë aplikuar detyrimi për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit për periudhën 2012 -2015, në zbatim të pikës 52 të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr.3, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014".

e-Për pagesën e taksave nga familjarët të kryhen njoftime publike në mediat Lokale,të hartohen njoftim vlerësimet në zbatim të nenit 70, pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 " Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Lokale", me ndryshime .

f-Të rakordojë me Ujësjiellës sha Kavajë për përcaktimin e numrit të kontratave të lidhura për furnizimin me ujë të pijshëm të cilat janë mbi 6000 të tilla, me qëllim dërgimin e njoftimeve abonentët familjarë, në zbatim të pikës nr. 52 të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03,datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014". Krahas kësaj të vendosë në Këshillin bashkiak për caktimin e Ujësjiellësit sha, në cilësinë e Agjentit Tatimor.

g- Sipas VKM nr. 660,datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjiellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes vendore", një pjesë e aksioneve të Ujësjiellësit sh.a, Kavajë i ka kaluar Këshillit Bashkiak ku edhe Këshilli Mbikëqyrës i Ujësjiellës sha Kavajë, emërohet nga Këshilli Bashkiak Kavajë. Bazuar në ligjin nr. 9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5,-Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas shkronjës ii) -përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella; nenin 7 të ligjit nr. 9920,datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar, pikës 7.1, të UMF, nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore", nga ana e Bashkisë Kavajë, të përgatitet akt-marrëveshja për pagesën e taksave dhe tarifave nga popullata, së bashku me faturat ujit të pijshëm, duke caktuar si agent tatimor Ujësjiellës sh.a, Kavajë, e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

f-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Kavajë me grup pune në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të inventarizojë subjektet e pa regjistruara dhe lokalet të cilët shërbejnë me tavolina përjashta për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi.

4.Gjetje: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashki nuk ka aplikuar masat administrative me gjobë për pagesat e vonuara, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH u nxorën për 2 vitet 2013-2014 lista me 201 subjektet të cilët kanë paguar me vonesë dhe duhet të ngarkohen me penalitete në vlerën 1,544,795 lekë .

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Kavajë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, të nxjerrë njoftim vlerësimit për 201 subjekte në vlerën **1,544,795 lekë** dhe të kërkojë arkëtimin e tyre.

5.Gjetje: Nuk janë administruar nëpërmjet arkës si dhe nuk janë kontabilizuar letrat me vlerë, biletat për taksën veterinare, parkimit, tregut e hapësirës publike për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

Rekomandimi. Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të administrojë nëpërmjet arkës letrat me vlerë ose biletat, për efekt të miradministrit të taksës veterinare, parkimit, tregut e hapësirës publike dhe blloqeve të gjobave të Policisë Bashkiake dhe IVMKT.

6. Gjetjet nga auditimi: Nuk janë bërë hyrje 154 copë pemë dekorative të llojit “Manjola” për vlerën 2,907,828 lekë (*mbi 2 metra lartësia dhe diametër 20 cm*), sipas urdhër shpenzimit nr. 564, datë 17.10.2014 dhe faturës subjektit nr. 167 datë 21.7.2014 të “Buna shpk” , për efekt të administrimit dhe inventarizimit tyre, në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në pikën 5-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, faqe 47-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Bashkia Kavajë të bëjë hyrje 154 copë pemë dekorative të llojit “Manjola” për vlerën 2,907,828 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 564, datë 17.10.2014 dhe faturës subjektit nr. 167 datë 21.7.2014, kjo për efekt të administrimit dhe inventarizimit tyre.

7.Gjetje: Për periudhën e audituar 2013-2014 për kontratat e lidhura, rezultoi se nuk është bërë arkëtimi i detyrimeve në kohë, konkretisht: nga dhënia me qira e banesave qytetarëve të ndryshëm për vitin 2013, nuk janë arkëtuar për 6 raste me një vlerë prej 47,640 lekë, për vitin 2014 për 18 raste në vlerë 145,414 lekë, ndërsa për dyqanet për vitin 2014 në dy raste për vlerën 40,680 lekë **gjithsej 233,734 lekë**, të cilat nuk janë ngarkuar si debitor për detyrime të pa shlyera, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Objektet e dhëna me qira nuk janë të regjistruara në emër të bashkisë Kavajë si prona të fituara me VKM nr. 1563 datë 26.11.2008, për rrjedhojë lidhja e kontratave vjen në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil, mbasi për këto prona nuk është bërë regjistrimi i pasurive të paluajtshme në ZVRPP Kavajë dhe nuk ekziston e drejta reale e pronësisë në emër të Bashkisë .

Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit në vlerën gjithsej **233,734 lekë**, nga personat debitorë.

8.Gjetje:Nga auditimi i kontratave të lidhura me qytetarët për banesë me qëllim strehimi me afat 1 vjeçar për vitet 2013-2014 del se për vitin 2013 janë lidhur 43 kontrata dhe 45 kontrata për vitin 2014, për lidhjen e kontratave referenca ligjore për vitin 2013 është vendosur VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndërsa për vitin 2014 është vendosur VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Udhëzimit nr. 257, datë 28.04.2014, mbasi për dhënien e banesave me qira nuk ka akte ligjore e nënligjore. Në lidhje me llogaritjen e detyrimit për pagesë është vendosur çmimi *10 lekë/m²* sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak, pra me një diferencë prej *140 lekë/m² më pak*. Duke kryer llogaritjet çmimit që përcakton VKM me vendimin e Këshillit Bashkiak rezulton një diferencë prej **8,811,600 lekë**, sipas pasqyrës bashkëlidhur .

Rekomadim: Bashkia Kavajë:

a- të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vleftën **8,811,600 lekë** sipas listës, si diferencë midis çmimit të KM dhe vendimit të Këshillit bashkiak për vitet 2013-2014 për kontrata e lidhura për qëllim banese.

b- Të përgatisë menjëherë materialin relatues dhe ta paraqesë në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak , për të marrë Vendimin përkatës të shfuqizimit të vendimit të nxjerrë në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

9-Gjetje: Policia Bashkiake nuk ka arkëtuar **81 gjoba në vlerën 103,500 lekë**, të vendosura për vitet 2013-2014. Mos vjelja e gjobave është në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 14 pika 2, dhe nenet, 9, 22, 30 dhe nenin 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Rekomandim: Policia Bashkiake të marrë masat për arkëtimin e **81 gjobave në vlerën 103,500 lekë**.

10.Gjetjet: Në zbatimin e kontratave, ka rezultuar se për mjaft objekte ndërtimi dhe veçanërisht për 5 operatorët ekonomikë të cilët edhe pse kishin lidhur kontrata me Bashkinë Kavajë që nga viti 2012-2013, ndërkohë nuk kishin hartuar aktrakordimet për punimet e kryera dhe faturat e paraqitura, akt marjet në dorëzim të objekteve duke mos kryer likuidimet për efekt mosdisponimi fondesh. Respektivisht, Operatori ekonomik: N. A-Rr. sha dhe S..B” shpk “E..” shpk , Ç...” shpk, “C...” shpk dhe “K...” .

Rekomandimi: Zyra e Menaxhimit të Kontratave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kavajë:

Të kryejë një rakordim të përgjithshëm për gjithë investimet ndërtimore dhe të nxjerrë faturat e pa likuiduara për gjithë objektet e përfunduara, veçanërisht për 5 operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë dorëzuar objektet respektivisht; N. A-Rr. sha dhe S..B” shpk “E..” shpk , Ç...” shpk, “C...” shpk dhe “K...”. Krahës kësaj të meren masa për hartimin e akt kolaudimeve, sigurimin e fondeve dhe kryerjen e likuidimeve me qëllim llogaritjen e penaliteteve si nga mos likuidimi në afat për arsye të mungesës së fondeve nga Bashkia apo mos përfundimi në afat i objekteve sipas parashikimeve në kontratat përkatëse.

11.Gjetje nga auditimi: IMTV Kavajë për periudhën datë 01.01.2009 deri 31.12.2014, ka vendosur 25 gjoba gjithsej në vlerën 18,900,000 lekë, nga të cilat vetëm 2 gjoba në vlerën 2,400,000 lekë, janë në proces gjyqësor, ndërsa nuk kanë filluar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës për kontabilizim 23 gjoba në vlerën 25,200,000 lekë (16,500,000 lekë + kamat vonesat në shumën 8,700,000 lekë).

Për mos nisjen e procedurave për arkëtimin e 23 gjobave në vlerën 16,500,000 lekë dhe 8,700,000 lekë kamat vonesa = 25,200,000 lekë, nga 2 Kryeinspektorët e IMTV, gjoba të cilat nuk janë arkëtuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtje administrative, në kundërshtim me paragrafin e dytë të pikës 6 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, sipas nenit 82 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtjen administrativ.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për vendosjen e gjobave, dërgimin në zyrën e financës për tu kontabilizuar si debitorë 23 gjobat në vlerën 25,200,000 lekë (16,500,000 lekë + kamat vonesat në shumën 8,700,000 lekë), ndërkohë nga Drejtoria Ligjore të kërkohej pranë Gjykatës të rrethit Gjyqësor Kavajë, nxjerrja e titujve ekzekutiv, për arkëtimin e gjobave së bashku me penalitetet shtesë.

12.Gjetje: Bazuar në VKM nr.1563 date 26.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronesi ose në përdorim të

Bashkisë Kavajë, të qarkut Tiranë”, lista e inventarit të pronave të Bashkisë Kavajë paraqitet me 690 pasuri dhe gjendja juridike e tyre: 18 prona janë në përdorim; 672 prona janë në pronësi, nga të cilat, 38 prona janë të regjistruara sipas vërtetimeve hipotekore, 7 prona janë në proces regjistrimi gjithsej 45 prona nga 690 ose 6.5 %, pra ka mos përkushtim të specialistëve për përfundimin e regjistrimit dhe pse ka mbi 6 vjet që këto pasuri i janë vënë në dispozicion bashkisë.

Nga auditimi i pasurive të regjistruara, në dy raste rezulton se ka mos përputhje të sipërfaqeve të përfituara sipas vendimit të KM nr. 1563 date 26.11.2008 me ato të regjistruara në fakt a) pasuria nr. 14/26 me emërtimin ish rezervat e shtetit Kavajë me 49.210 m2, ndërsa sipas vërtetimit hipotekor nr. 45/50, datë 29.05.2006 regjistruar 48.552 m2, me një diferencë prej 658 m2 dhe b) pasuria nr. 3/6 sipas vendimit është 10.074 m2, ndërsa sipas vërtetimit hipotekor nr. 40/34 është regjistruar 8.453 m2, me një diferencë prej 1.621 m2 më pak.

Rekomadimi: Bashkia Kavajë të marrë masat për përfundimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas VKM Nr. 1563 date 26.11.2008 dhe pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive në ZVRPP Kavajë, të nisë inventarizimin fizik dhe përfshirjen e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël për zërat “Troje, terrene” dhe objekte të ndryshme, duke i pasqyruar në bilancin e vitit 2015.

Bashkia Kavajë të fillojë procedurat ligjore për regjistrimin e pasurive nr. 14/26 me emërtimin ish rezervat e shtetit Kavajë, me një diferencë prej 658 m2 dhe pasuria nr. 3/6, me një diferencë prej 1.621 m2 më pak sipas VKM Nr. 1563 date 26.11.2008 .

13.Gjetje: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Kavajë. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi: Bashkia Kavajë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 1240, datë 10.09.2008, dhe aplikimi për regjistrim në ZVRPP Kavajë, për regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

14. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka miratuar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, hartën e kategorive ekzistuese të përdorimit të tokës dhe hartën e nën njësive strukturore ekzistuese, ndërsa detajimi i planit të përgjithshëm vendor, bëhet pasi të jetë miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, veprim në mospërputhje me nenin 27, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimi e territorit” dhe nenin 7, të VKM nr. 480, datë 22.06.2011 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” .

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të marrë masa, që në asnjë rast të mos miratojë leje zhvillimore ndërtimi, pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor.

15. Gjetje: Kryetari i Bashkisë Kavajë nuk ka ngritur Këshillin Teknik, i cili duhet të përbëhet me specialist të fushës së planifikimit të territorit, përfaqësues të enteve dhe të

ndërmarrjeve të varësisë, dhe ti sugjerojë Kryetarit të Bashkisë, vlerësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për kërkesat për leje zhvillimore ndërtimi për subjekte private dhe publike, veprim në mospërputhje me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar dhe neni 45, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa, të ngrejë Këshillin Teknik të përbërë nga specialist të fushës së planifikimit të territorit, përfaqësues të enteve dhe të ndërmarrjeve të varësisë.

16. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë, nuk ka hapur dhe nuk ka hedhur në portalin Ueb në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, të dhënat për leje zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike, veprim në mos përputhje me nenin 51, 52 dhe 53, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të planifikimit të territorit”.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të marrë masa, të hedh në portalin Ueb- Regjistrin e Planifikimit të Territorit, të dhënat për leje zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike.

17. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë, për vitin 2013-2014, nuk ka hapur dhe nuk ka hedhur në portalin Ueb të sistemit GIS, të dhënat për leje zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike, veprim në mospërputhje me shkronjën “b” nenin 55, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të marrë masa, të hedh në portalin Ueb- të sistemit GIS, të dhënat për leje zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike.

18. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për vitin 2013-2014, nuk ka dërguar në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, projektet e plota të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, dhe në version elektronik, veprim në mospërputhje me nenin 70/12, të ligjit nr. nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, të dërgojë në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, projektet e plota të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, dhe në versionin elektronik.

19. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, nuk ka kryer vëzhgime për zhvillimet në territor, për studimin, vlerësimin, parashikimin e rreziqeve dhe të tendencave, për parandalimin e zhvillimeve të dëmshme, për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit, si dhe nuk janë dërguar në Agjencinë Kombëtar të Planifikimit të Territorit, raportet vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit, si dhe nuk janë dërguar informacione dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokës, veprim në mospërputhje me pikën 1, 3, 4 neni 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, të kryej vëzhgime për zhvillimet në territor, studimin, vlerësimin, parashikimin e rreziqeve dhe të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit, si dhe të dërgojë në Agjencinë Kombëtar të Planifikimit të Territorit raportet vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit dhe informacione dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokë.

20.Gjetje: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit në **10 raste**, kanë bërë miratimin e strukturës ndërtimore për objekte private, duke mos zbatuar distancat nga kufiri i pronës, veprim në mospërputhje me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “l” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, që në miratimin e strukturës ndërtimore të objekteve private dhe publike të zbatojë distancat nga kufiri i pronës dhe strukturat e tjera ndërtimore.

21. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në të gjitha rastet, nuk ka bërë verifikimin e zërave të punimeve të ndërtimit, sipas manualit për preventivimin me çmimet e punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, veprime në mospërputhje me VKM nr. 407, datë 27. 06.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, dhe të bëjë verifikimin e zërave të punimeve të ndërtimit, sipas manualit për preventivitet me çmimet e punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, duke bërë dhe llogaritjet përkatëse dhe evidentuar diferencat.

22.Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit për ndërtimin e Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara, në lejen zhvillimore të ndërtimit ka miratuar 10.78 m² më shumë truall, se marrëveshja e lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe shoqatës Alternative. Drejtoria e Planifikimit të Territorit nuk ka kërkuar nga ZVRPP Kavajë, ndarjen e pasurisë nr. 14/230, për sipërfaqen e truallit për ndërtimin e Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara, veprim në mospërputhje me pikën 1 të nenit 70/3, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 29.04.2011 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, të korrigjojë në lejen zhvillimore të ndërtimit dhe në planvendosje truallin me sipërfaqe +10.78 m², sa miratuar më shumë për ndërtimin e Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara. Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa dhe të kërkojë nga ZVRPP Kavajë, ndarjen e pasurisë nr. 14/230, në lidhje me truallin e Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara.

23.Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në të gjitha raste në planvendosjen bashkëlidhur lejes zhvillimore të ndërtimit, nuk ka përcaktuar kondicionet teknike si distanca nga kufiri i pronës, nga strukturat e tjera dhe trupi i rrugës, veprim në mospërputhje me nenin 70/3, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

23.1Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, që në planvendosjen bashkëlidhur lejes zhvillimore të ndërtimit, të përcaktojë kondicionet teknike si; distanca nga kufiri i pronës, nga strukturat e tjera dhe trupi i rrugës.

24. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në **14 raste**, lejet përdorimit të dërguar në ZVRPP Kavajë, nuk i ka plotësuar me dokumentacionin përkatës, veprim në mospërputhje me kreun II, neni 9 dhe 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masa, që për të gjitha lejet përdorimit që dërgon në ZVRPP, të plotësohen me dokumentacionin plotë tekniko ligjor.

25.Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në **14 raste**, ka miratuar lejet zhvillimore të ndërtimit për punime në infrastrukturë, pa u plotësuar dokumentacioni tekniko ligjor, veprim

në mospërputhje me nenin 70/1 dhe pikën 1, 2, 3, të nenit 70/14, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 29.04.2011 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me nenin 14 e 19, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të marrë masa, para miratimit të lejeve zhvillimore të ndërtimit për punimet në infrastrukturë, të kërkojë plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, duke e përputhur atë me kërkesat ligjore.

26.Gjetje: Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë për periudhën 2013-2014, nuk ka inventarizuar për çdo fletë dokumentacionin që ndodhet në dosje, si dhe nuk ka hartuar fletë inventari për dokumentacionin përkatës, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

26.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të marrë masa, të fillojë inventarizimin e dosjeve, duke hartuar edhe fletët e inventarit për çdo dosje.

27-Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 e 2014 u konstatuan kryerja e disa shpenzimeve për kulturore, fetare, pritje e përcjellje dhe të tjerë, çka ka krijuar shkelje të disiplinës financiare në vlerën **1,548,250 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të analizojë me përgjegjësi shpenzimet e kryera për rastet e trajtuara më lart në vlerën **1,548,250 lekë** dhe për të ardhmen, **të ndalojë kryerjen** e shpenzimeve për aktivitetet kulturore, fetare dhe pritje e përcjellje nga fondet e Bashkisë. Për të gjitha nevojat që do ketë Bashkia për këto lloj shpenzimesh, të zbatohen kërkesat, duke hartuar programet dhe listat përkatëse, për diferencat që do të krijohen të plotësohen me pagesa të pjesëmarrësve në këto evenimente.

28.Gjetje: Për administrimin e tregut dhe parkimit, janë lidhur me agjentë tatimor privat kontratat nr. 1473 datë 16.01.2013, nr. 1651 datë 31.12.2013, nr. 1472 datë 16.01.2013, nr. 1650 datë 31.12.2013, nr. 1471 datë 16.01.2013 dhe nr. 1474 datë 16.01.2013. Në këto kontrata ka pasaktësi e paqartësi ligjore, pasi nuk janë përcaktuar penaltitetet, kontratat nuk shoqërohen harta e skica sipas shesheve dhe vendeve përkatëse, për sipërfaqen dhe numrin e tregtarëve e automjeteve, dokumente bazë për saktësinë e vendosjes të vlerës në kontratë. Për pasojë të mos ndjekjes së këtyre kontratave, është shkaktuar Bashkisë Kavajë një e ardhur e munguar në vlerën **1,700,000 lekë** për vitin 2013-2014.

Rekomandimi: Bashkia Kavajë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa dhe të bëjë rakordimin me agjentët privat,për kontratat e lidhura për administrimin e tregut dhe parkimit, dhe të fillojnë procedurat ligjore për rivlerësimin e tyre juridik ose për zgjidhjen e këtyre kontratave si të pa mbështetura në dispozita ligjore .

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e

dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim **për shpërblimin e dëmit në vlerën 32,839,607 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje: Për 2 vitet 2013 dhe 2014 janë lidhur kontrata në **4 raste** me qira truall, dy kontrata me objekte ndërtimore dhe 13 kontrata për dyqane dhe në një rast rezultoi se është lidhur një kontratë qiraje me datë 18.09.2007 midis Qiradhënësi Bashkisë Kavajë, përfaqësuar nga ish-kryetari i bashkisë z. R.RR, dhe qiramarrësi subjekti “A...” shpk, jashtë kompetencave ligjore për objektin dy katësh “magazina nr. 20” tek ish ndërmarrja e grumbullimit me sipërfaqe 621 m2 dhe dy katet 1241 m2, me afat 10 vjeçar, nga data 11.10.2006 deri 10.10.2016

- Lidhja e kësaj kontrate nuk ka qenë në kompetencë të Bashkisë Kavajë, pasi sipërfaqja e saj është mbi 200 m2. Kjo kompetencë i takon Ministrisë së Ekonomisë si përfaqësuese e pronës shtetërore, sipas kërkesave të pikës 5/c të VKM nr. 315, datë 24.04.2003, gjithashtu nuk janë zbatuar procedurat e dhënies me qira në zbatim të kërkesave të VKM nr. 315, datë 24.04.2003, në kundërshtim me pikën 1, kap II. Procedurat e dhënies me qira të pasurisë publike. Në lidhje me llogaritjen pagesës nuk është kryer për sipërfaqen funksionale të objektit prej 429 m2 truall funksional jo në ndërtesë, për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010 duke shkaktuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën prej **617,760 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 27.08.2004 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 315, datë 24.04.2003, pika 1 të kapitullit III të vendimit.

- Kjo kontratë nuk është lidhur para noterit në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, neni 56 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë” i ndryshuar.

Rekomadimi: Bashkia Kavajë të fillojë procedurat ligjore për ndërprerjen e kontratës së qirasë, si e pavlefshme dhe e lidhur në kundërshtim me ligjin nga ish-kryetari i Bashkisë Kavajë z. R.RR dhe qiramarrësi subjekti “A...” shpk, jashtë kompetencave ligjore, për objektin dy katësh “magazina nr. 20”, tek ish ndërmarrja e grumbullimit me sipërfaqe 621 m2 dhe dy katet 1241 m2, me afat 10 vjeçar, nga data 11.10.2006 deri 10.10.2016 dhe të kërkojë arkëtimin e vleftës prej **617,760 lekë**, si detyrim për mos përfshirje në kontratë qiraje të truallit funksional.

2.Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në **6 raste**, ka llogaritur dhe arkëtuar më pak taksë ndikimi në infrastrukturë në shumën **535,801 lekë**, veprim në mospërputhje me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 61, datë 24.12.2012 “Për disa ndryshime në sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **535,801 lekë**, si më poshtë:

-1,490 lekë për subjektin ndërtues “B..” sh.p.k. sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për godinë banimi 8 kat (1 kat shërbime + 7 kat banesë + 1 kat papafingo + 1 kat nën tokë);

- 119,385 lekë për subjektin ndërtues “J & L” sh.p.k sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për ndërtim godinë banimi 3 kat në shumën;

- 19,127 lekë për subjektin ndërtues “A-A” sh.p.k sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për ndërtim godinë banimi dhe shërbimi 5 kat + 1 kat nëntokë;

- 205,109 lekë për subjektin ndërtues “B-S” shpk sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për ndërtimin e Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara objekt 1 kat;

- 6,038 lekë për subjektin ndërtues “J & A” sh.p.k sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për godinë banimi 2 kat në shumën;

- 184,652 lekë për subjektin ndërtues “A...” sh.p.k sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë për godinë banimi 1 kat .

3. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në 3 raste, taksë ndikimi në infrastrukturë e ka llogaritur dhe arkëtuar më pakë në shumën 43,062 lekë, veprim në mospërputhje me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 61, datë 24.12.2012 “Për disa ndryshime në sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 43,062 lekë, si më poshtë:

- 2,750 lekë për subjektin ndërtues “J & L” sh.p.k sa llogaritur më pakë taksë ndikimi në infrastrukturë për objekt banimi 2 kat + papafingo në shumën;

- 25,200 lekë për subjektin ndërtues “J & A” sh.p.k sa llogaritur më pakë taksë ndikimi në infrastrukturë për ndërtim godinë banimi 2 kat;

- 15,112 lekë për subjektin ndërtues “L.. ” sh.p.k. sa llogaritur më pakë taksë ndikimi në infrastrukturë për objekt banimi 4 kat.

3.Gjetje: Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Tironsave (rruga hyrëse e qytetit)” sipas Kontratës datë 20.01.2015 në vlerën 158,647,680 leke pa tvsh, në preventivin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe në preventivin e paraqitur në tender nga operatori ekonomik “G...company”, janë përfshirë pajisjet me tvsh. Në kundërshtim UKM nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” dhe veças vlera pajisjeve etj, e për rrjedhojë është rritur artificialisht vlera e kontratës në shumën 3,338,900 lekë (16,694,449 x 20%), si dhe nga operatori ekonomik “G...company”, vlera e tvsh është përfituar padrejtësisht në **shumën 3,137,900 lekë** (15,689,500 x 20%) **dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga **operatori ekonomik “G.. company”,** në vlerën **3,137,900 lekë.**

4.Gjetje: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “Ndërtim i kopshtit në lagjen nr.4, kontrata datë 04.11.2014 me vlerë 20,609,694 lekë, pa TVSH, në preventivin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe në preventivin e paraqitur në tender nga operatori ekonomik “P..... V...”, janë përfshirë pajisjet me TVSH. Në kundërshtim me UKM nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” dhe veças vlera pajisjeve dhe kaldajë, etj, e për rrjedhojë nga autoriteti kontraktor është rritur artificialisht vlera e kontratës në shumën 382,972 lekë (1,914,859x 20%), si dhe nga operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit”, vlera e tvsh është përfituar padrejtësisht në shumën **287,273 lekë** (1,436,368 x 20%) **dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit” në vlerën **287,273 lekë,** pa TVSH.

5.Gjetjet: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “Sistemim asfaltim i sheshit te Axhensisë (faza II)” Kavajë, kontrata datë 2014 lekë, me vlerë 3,148,340 lekë Fitues operatori “D.. -1”

Komisioni i vlerësimit të ofertave para këtij fakti duhej ti sugjeronte titullaritit konfiskimit e “sigurimit të ofertës” në shumën 60,000 lekë, për secilin nga të dy operatorët ekonomikë, pasi në vlerësimin e bërë në mënyrë elektronike rezulton se sipas komisionit të vlerësimit të ofertave të tre operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender i plotësojnë kriteret për kualifikim.

Nga auditimi rezulton se të dy operatorët ekonomikë që janë tërhequr nga tenderi, “E....i 2000 ,“C.. R...”, kanë paraqitur vlerën e ofertës më të ulët se oferta e shpallur fituese,

respektivisht në vlerën 563,068 lekë dhe 91,699 lekë e cila është më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës. Vlera e sigurimit të ofertës është 60,000 lekë, pra më e vogël se diferenca midis ofertës fituese dhe ofertës së operatorëve ekonomikë që janë tërhequr nga tenderi dhe komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të ndërpriste procedurën e prokurimit dhe nuk duhej të shpallte fituesin. Duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”. Nga ana autoritetit kontraktor është favorizuar operatori ekonomik “D...” në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 1 dhe Neni 2, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **563,068 lekë**, pa tvsh, për buxhetin e Bashkisë Kavajë .

Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga operatori ekonomik “D.....”, në vlerën **563,068 lekë** pa TVSH.

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”, (Tender i anuluar). Njoftimi i fituesit datë 20.06.2014. Titullari me shkresën nr.727/4, datë 19.08.2014, ka anuluar tenderin pasi operatori ekonomik i shpallur fitues nuk arriti të paraqitet brenda afatit ligjor për nënshkrimin e kontratës. Ndërkohë Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar konfiskimin e garancisë së ofertës operatorit ekonomik “S...t CO” në vlerën **90,860 lekë**, dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi z. E.A.

Në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”.

Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga operatori ekonomik “S... CO” në vlerën **90,860 lekë** pa TVSH.

7. Gjetje: U konstatua shkelje të dispozitave ligjore me efekte financiare në auditimin e pagave në vlerën **1,765,362 lekë dëm ekonomik**, për vitin 2013 dhe 2014 konkretisht:

a. në **2 raste** janë kryer pagesa për leje të zakonshme për vlerën **47,772 lekë**, përkatësisht: A.K 31,155 lekë sipas borderosë së muajit Dhjetor 2013 dhe F.T 12,272 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 617, datë 14.8.2013, në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2011 në zbatim të VKM nr. 472 datë 02.7.2011 pika 1/d “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

b. në **4 raste** për vitin 2013 dhe 2014 janë dhënë shtesa page për vështirësi për vlerën **562,800 lekë**, pasi nuk kanë mbështetje ligjore, përkatësisht: A.Sh 80,400 lekë, G.K 158,400 lekë, A.Vu 163,200 lekë dhe I. Z 160,800 lekë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

c. **150 punonjës** të bashkisë Kavajë kanë përfituar pagesë në shkelje të disiplinës financiare paligjshme, për orë jashtë orarit punës ose për ditë pushimi për vlerën **303,528 lekë**, sipas listë pagesave të muajit Nëntor të vitit 2013 dhe sipas urdhër shpenzimit nr. 723, datë 29.12.2014 për punonjëset e QKR, në kundërshtim me pikën 1/2,3 dhe 3/a e b të udhëzimit MF nr. 16 datë 20.07.2011 në zbatim të pikës 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

d. janë paguar padrejtësisht **22 Këshilltar Bashkiak**, në mungesën e listprezencës për vlerën **1,154,790 lekë**, pasi nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013 dhe 2014, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

a. vlerën **47,772 lekë**, përfituar në mënyrë të paligjshme pagesa për leje të zakonshme, për A. K vlera 31,155 lekë sipas borderosë së muajit dhjetor 2013 dhe F.T vlera 12,272 lekë .

b. vlerën **562,800 lekë**, përfituar në mënyrë të pa ligjshme, shtesë page për vështirësi pa mbështetje ligjore për vitin 2013 dhe 2014, për A.Sh 80,400 lekë, G.K 158,400 lekë, A. V 163,200 lekë dhe I.Z 160,800 lekë.

c. vlerën **1,154,790 lekë**, pagesa të paligjshme për 22 Këshilltarëve, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak të cituara rast pas rasti.

d. Bashkia Kavajë të marrë masa për programimin e nevojave dhe burimeve njerëzore që ka institucioni, kryesisht për shërbime publike, duke mos kryer pagesa për punë jashtë orarit të punës, por të bëjë argumentimet ligjore për raste emergjente dhe fatkeqësi natyrore, e të shikojë mundësitë e konvertimit të punës me ditë pushimi në vazhdimësi.

8. Gjetje: Me veprimet e arkës për vitin 2013 dhe 2014 u konstatuan shkelje financiare për vlerën **1,750,531 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

-vlera 26,532 lekë tarifë ushqimore e kopshtit e pa arkëtuar nga 8 persona, për vitin 2014, sipas listës fëmijëve në bashki.

-vlera 23,999 lekë tarifë ushqimore e çerdhes e pa arkëtuar nga 8 persona, për vitin 2014, sipas listës fëmijëve në bashki.

-vlera 1,700,000 lekë detyrim kontraktor i pa arkëtuar për taksën e tregut e parkimit për vitin 2013 dhe 2014, përkatësisht:

a. I. K vlera 985,000 lekë taksë tregu (485,000+500,000), pasi për vitin 2013 ka paguar 1,315,000 lekë nga 1,800,000 lekë, në kundërshtim me kontratën nr.1473 datë 16.01.2013, ndërsa për vitin 2014 ka paguar 700,000 lekë nga 1,200,000 lekë, në kundërshtim me kontratën nr.1651 datë 31.12.2013.

b. L.D vlera 685,000 lekë taksë tregu (385,000+300,000), pasi për vitin 2013 ka paguar 1,415,000 lekë nga 1,800,000 lekë, në kundërshtim me kontratën nr.1472 datë 16.01.2013, ndërsa për vitin 2014 ka paguar 900,000 lekë nga 1,200,000 lekë detyrimi i kontratës, në kundërshtim me kontratën nr.1650 datë 31.12.2013.

c. vlera 30,000 lekë, përkatësisht M. C vlera 20,000 lekë dhe R.Gj vlera 10,000 lekë, diferencë takse parkimi, në kundërshtim me kontratat nr.1471 datë 16.01.2013 dhe nr.1474 datë 16.01.2013

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,750,531 lekë**, përkatësisht:

-vlera **26,532 lekë** tarifë ushqimore e kopshtit e pa arkëtuar nga 8 persona, për vitin 2014, sipas listës fëmijëve në bashki.

-vlera **23,999 lekë** tarifë ushqimore e çerdhes e pa arkëtuar nga 8 persona, për vitin 2014, sipas listës fëmijëve në bashki.

-vlera **1,700,000 lekë** detyrim kontraktor i pa arkëtuar për taksën e tregut e parkimit për vitin 2013 dhe 2014, përkatësisht: I.K vlera 985,000 lekë, L.D vlera 685,000 lekë, M.C vlera 20,000 lekë dhe R.Gj vlera 10,000 lekë,

9. Gjetje: Për vitin 2013 dhe 2014 nuk është zbritur nga pagesa firmës pastrimit **K.... shpk**, zëri i punës “Heqje e mbetjeve solide e inerte” dhe zëri “Lagje rrugë e sheshe”, për vlerën **2,362,605 lekë dëm ekonomik** (528,580+707,675+ 889,200+237,150).

-Nuk është zbritur në situacionet e “K....l shpk” **vlera 237,150 lekë**, për zërin “Lagje rrugë e sheshe”, i cili nuk parashikohet për periudha dimërore përkatësisht në muajin tetor dhe dhjetor 2013, sipas urdhër shpenzimeve nr. 286 datë 16.6.2014 dhe nr. 213 datë 02.5.2014.

b. Zëri “Lagje rrugë e sheshe” nuk i është zbritur subjektit pastrimit **E.T. K shpk***, për vlerën **36,159 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 575 datë 17.10.2014, për muajin janar- shkurt 2013, pasi është periudhë dimërore, çka bie ndesh me kontratën nr. 572.5 datë 16.01.2013

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera prej **2,398,764 lekë**, nga e cila nga firma e pastrimit “Korsel” shpk vlera 2,362,605 lekë (528,580+707,675+ 889,200+237,150) dhe nga subjekti i pastrimit “E.T. K” shpk për vlerën **36,159 lekë**, pasi për vitin 2013 dhe 2014 subjekti K...

shpk ka përfituar në mënyrë të padrejtë vlerën e zërit “*Heqje e mbetjeve solide e inerte*”, dhe zërin “*Lagje rrugë e sheshe*”, i cili nuk parashikohet për periudha dimërore përkatësisht në muajin Tetor dhe Dhjetor 2013.

10. Gjetje: Sipas urdhër shpenzimit nr. 646, datë 3.12.2014 është likuiduar operatori ekonomik “**5 v.... shpk**” për “Ndërtim e Kopshtit në lagjen nr. 4”, rezulton se **vlera 90,912 lekë TVSH është marrë 2 herë (454,560 x20%)**, pasi në situacionin nr. 2 zërat e punës “Makineri dhe Pajisje për centralin Elektrik” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e TVSH. Veprime në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh e cila vendoset në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti juridik dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **90,912 lekë** nga subjekti “**5 v... shpk**”, për TVSH marrë 2 herë në objektin “ndërtim e Kopshtit në lagjen nr. 4”, pasi subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve”.

celulare, për vitin 2013 dhe 2014 dhe të pa ndalura nga sektori i financës në pagë.

11.Gjetje ng auditimi: Sipas urdhër shpenzimit nr. 402, datë 24.7.2014 dhe faturës nr. 36 datë 18.6.2014 me procedurën e shërbimeve me vlera të vogla është likuiduar “**A... shpk**” për objektin “Riparim asfalti në rrugët e qytetit për 325 m²”, për vlerën **432,000 lekë dëm ekonomik**, rezulton se shpenzimi është dubluar dhe nuk argumentohet me dokumentacion, pasi rrugët “Bulevardi Josiv Bundo” dhe “Indrit Cara”, në të njëjtën periudhë i janë nënshtruar më parë rikonstruksionit sipas tenderit datë 26.5.2014 dhe më pas sipas kontratës datë 7.7.2014 të subjektit “A... shpk”. Gjithashtu mungon dokumentacioni justifikues si preventivi për çdo rrugë, nuk ka fotografime dhe skica përmasimi para dhe pas meremetimit të rrugëve. Për rrjedhojë ky shpenzim nuk justifikohet.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **432,000 lekë, nga z, Xh.Sh, I.Z dhe I.Ç me nga 144,000 lekë** sejcili, pasi shpenzimi nuk argumentohet me dokumentacion të veçantë dhe paraqet dublim punimesh për të njëjtën periudhë.

12.Gjetje: Me veprimet e magazinë për vitin 2013-2014 u konstatuan shkelje me efekte financiare për vlerën **657,882 lekë dëm ekonomik (592,787+65,095)**,

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **657,882 lekë**, për përfitim të paligjshëm karburanti dhe për disa artikuj të panjohur për vitin 2013 dhe 2014 nga punonjësit e bashkisë, konkretisht: S.C vlera 158,813 lekë, K.Sh. vlera 164,480 lekë, I.Z për vlerën 134,747 lekë, I.C, për vlerën 134,747 lekë, D.H vlera 40,920 lekë, E.B vlera 3,720 lekë, I.Sh vlera 11,160 lekë dhe M. P vlera 9,295 lekë.

13. Gjetje: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **1,288,526 lekë** ndaj operatorit ekonomik “**C.. sh.p.k.**”, në situacionimin e volumeve të punimeve për **13 zëra punimesh**, me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “Rikonstruksion i rrugës “Kosova”, Bashkia Kavajë”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 1031/2, datë 05.09.2012.

Rekomandimi: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,288,526 lekë**, nga operatori ekonomik “**C...**” **sh.p.k.**, paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “**Rikonstruksion i rrugës “Kosova”, Bashkia Kavajë**”.

14.Gjetje: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **1,133,780 lekë** ndaj operatorit ekonomik “**S...**” **sh.p.k.**, në situacionimin e volumeve të punimeve për **12 zëra punimesh** me diferenca volumesh të pa kryera, për ndërtimin e

objektit “Rikonstruksion të rrugës”Pal Xhumari”, Kavajë”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 1026/2, datë 04.09.2012 .

Rekomandimi: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,133,780 lekë**, nga operatori ekonomik “S...” sh.p.k. , paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion të rrugës”Pal Xhumari”, Bashkia Kavajë”.

15.Gjetje: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **998,656 lekë** ndaj operatorit ekonomik “E....” sh.p.k. , në situacionimin e volumeve të punimeve për **11 zëra punimesh** me diferenca volumesh të pa kryera, për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion i rrugës “Serave” dhe rrugës “Mësuesi””, Bashkia Kavajë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 665/2, datë 26.06.2013.

Rekomandimi:Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **998,656 lekë**, nga operatori ekonomik “E....” sh.p.k. , paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës “Serave” dhe rrugës “Mësuesi””, Kavajë”.

16.Gjetje: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe zbatimi i objektit “Rikonstruksioni i trotuareve të anës perëndimore të shëtitores Josif Bundo” Kavajë , rezulton se janë raportuar punime të pakryera në kundërshtim me kontratën nr.1235/2 prot, datë 23.10.2012 dhe preventivin e ofertes fituese duke përfutur padrejtësisht Operatori ekonomik “H....” shpk në vlerën prej **278,496 lekë pa tvsh** .

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **278,496 lekë** pa tvsh lekë, ndaj Operatorit ekonomik “H...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1235/2 prot., datë 23.10.2012 për punime të pakryera në objektin “Rikonstruksioni i trotuareve të anës perëndimore të shëtitores Josif Bundo” Kavajë.

17.Gjetje: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe zbatimi i objektit “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Gjergo”, rezulton se janë raportuar punime të pakryera në kundërshtim me kontratën nr. 666/1 prot, datë 26.06.2013 dhe preventivin e ofertes fituese duke përfutur padrejtësisht Operatori ekonomik “M... -1” shpk, në vlerën prej **1,044,559 lekë pa tvsh** .

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,044,559 lekë** pa tvsh ndaj Operatorit ekonomik “M...-1” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 666/1 prot., datë 26.06.2013 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Gjergo” Kavajë.

18-Gjetje: Për tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Gjergo”, rezulton se nga konceptuesi i kontratës z. E.A me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve, është shtuar vlera e kontratës bazë nr. 666/1 prot, datë 26.06.2013, mbi kufirin e lejuar prej 20%, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashksië Kavajë në vlerën **67,649 lekë** pa tvsh, në kundërshtim me kapitullin 4, pika 5, paragrafi 7, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **67,649 lekë** pa tvsh ndaj z. Eduart Aliu me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve.

19.Gjetje: Drejtoria e Taksave nuk u ka dërguar njoftim vlerësim për pagimin e taksës së shërbimit dhe pastrimit 17 institucioneve shtetërore, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36 datë 21.11.2014, duke mos arkëtuar për 2 vitet 2013-2014 vlerën e taksave prej **1,670,000 lekë**, sipas pasqyrës trajtuar në pikën 7-Auditimi i taksave faqe të Projektraportit të auditimit.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Kavajë bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008

“Për Procedurat tatimore” i ndyshuar, ndaj 17 Institucioneve Shtetërore, të nxjerë njoftim vlerësimet në vlerën **1,670,000 lekë**.

20.Gjetje: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka bërë rakordim, me qëllim evidentimin e personave të cilët, duhet të paguanin taksën e ndërtimit, për pasojë **9 persona** kanë paguar më pak taksë mbi ndërtesën, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak Kavajë nr. 36 datë 21.11.2014 duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën prej **498,630 lekë**.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të nxjerrë njoftim vlerësimet ndaj **9 subjekteve në vlerën 498,630 lekë**.

21.Gjetje: Nga mbikëqyrja e Dosjeve të subjekteve të Biznesit të madh, rezulton se **6 subjekteve**, nuk ishin llogaritur detyrimet për taksat vendore, në kundërshtim me nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndyshuar, ku duhet të paguajnë taksat në vlerën 422,490 lekë së bashku me kamat vonesën prej 105,622 lekë një detyrim prej **528,112 lekë**, të analizuar si më poshtë:

1.Subjekti E.K, me aktivitet“Prodhim Inerte” me NUIS - L 02927803T, nga mbikqyrja e Dosjes të subjektit në Zyrën e taksave rezulton se për gjendjen e këtij subjekti nga Task-Forca, nuk është mbajtur aktverifikim. Ky subjekt aktualisht vazhdon aktivitetin, por nga ana e punonjësve të Drejtorisë Taksave Kavajë, nuk është nxjerrë njoftim vlerësim për vitin 2013 në vlerën **98,820 lekë** dhe vitin 2014 në vlerën **103,620 lekë**, për pasojë subjekti E.K nuk është njoftuar për shlyerjen e taksave, duke shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Kavajë së bashku me kamat vonesat në vlerën **253,050 lekë**.

2.Subjekti V.Sh me aktivitet Këmbim Valutor me NUIS- K 83303801M, nga mbikqyrja e Dosjes të subjektit në Zyrën e taksave rezulton se për gjendjen e këtij subjekti nga Task-Forca, është mbajtur aktverifikimi datë 11.03.2013. Ky subjekt nuk vazhdon aktivitetin por nuk është Çregjistruar në QKR dhe nga ana e punonjësve të Drejtorisë Taksave Kavajë nuk është nxjerë njoftim vlerësim për vitin 2013 për vlerën 73,620 lekë dhe vitin 2014 për vlerën 16,430 lekë, për pasojë subjekti Vaid Shaba nuk është njoftuar për shlyerjen e taksave duke shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Kavajë së bashku me kamat vonesat në vlerën **112,562 lekë**.

3.Ujësjiellësi sha,Kavajë (S.Gj) me NUIS - J62903868I, aktualisht vazhdon aktivitetin, por nga ana e punonjësve të Drejtorisë Taksave Kavajë, nuk është nxjerë njoftim vlerësim për vitin 2013 për vlerën 65,000 lekë dhe vitin 2014 për vlerën 65,000 lekë, për pasojë nuk është njoftuar Ujësjiellësi,sha,Kavajë për shlyerjen e taksave, duke shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Kavajë së bashku me kamat vonesat në vlerën **162,500 lekë**.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Kavajë, të nxjerë njoftim vlerësimet ndaj **3 subjekteve në vlerën 528,112 lekë**, respektivisht:Subjekti E.K, në vlerën 253,050 lekë, Subjekti V.Sh 112,562 lekë dhe Ujësjiellësi, sha, Kavajë në vlerën 162,500 lekë.

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (3E): ne 5 objekte ne vlerën **5,446.865 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor ka miratuar ndryshimin e volumeve për objektin “Rikonstruksion i shëtitores “Josif Bundo” dhe lulishtes “Indrit Cara”, Bashkia Kavajë dhe nuk ka ngritur grup pune për të bërë negocimin e çmimeve për zërat e rinj të

punimit, gjithashtu nuk ka kontrolluar çmimet e pasqyruara në preventivin e ripunuar, të cilat janë përcaktuar sipas analizës së çmimit, nga ku u konstatua se nga përlllogaritja e gabuar e çmimeve të zërave të punimit, për përcaktimin e vlerës së preventivit të ripunuar, rezulton se vlera e preventivit të ripunuar është rritur në mënyrë artificiale, ka sjell një mos efektivitet të përdorimit të fondeve buxhetore **në vlerën 3,614,060 lekë**, në kundërshtim me, gjerat “a” dhe “b” të pikës 5, neni 33, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjerën “a”, paragrafi 9, pika 5, kreu III, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe me pikën 8.1 dhe 8.2, kreu II, të Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”.

2. Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Çezmja e Sharrës”, me kontratë nr. 710/2 prot, datë 10.07.2013 me vlerë 9,607,080 leke pa tvsh, si rezultat i llogaritjes gabim i ofertës anomalish të ulët në kundërshtim me DST, pika 3- Vlerësimi i Ofertave, seksioni Oferta anomalisht të ulëta, nënpika 3/1 si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V- Zhvillimi i procedurave, pika 4- Hapja dhe vlerësimi i ofertave-, shkronja “ë”, është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “D...-1” Sh.p.k. me ofertë me vlerë 8,594,957 lekë pa TVSh, ka sjell një mos efektivitet të përdorimit të fondeve buxhetore **në vlerën 1,012,123 lekë**.

3. Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Besa” me kontratë nr. 664/2 prot, datë 26.06.2013 me vlerë 2,839,869 leke pa tvsh, si rezultat i llogaritjes gabim i ofertës anomalish të ulët në kundërshtim me DST, pika 3- Vlerësimi i Ofertave, seksioni Oferta anomalisht të ulëta, nënpika 3/1 si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V- Zhvillimi i procedurave, pika 4- Hapja dhe vlerësimi i ofertave-, shkronja “ë”, është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “D.....-1” Sh.p.k. me ofertë me vlerë 2,569,217 lekë pa TVSh, ka sjell një mos efektivitet të përdorimit të fondeve buxhetore **në vlerën 270,652 lekë**.

4. Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Skuraj (faza e II ndriçimi)” me kontratë nr. 713/2 prot., datë 12.08.2013 me vlerë 4,127,532 lekë pa tvsh, si rezultat i llogaritjes gabim i ofertës anomalish të ulët në kundërshtim me DST, pika 3- Vlerësimi i Ofertave, seksioni Oferta anomalisht të ulëta, nënpika 3/1 si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V- Zhvillimi i procedurave, pika 4- Hapja dhe vlerësimi i ofertave-, shkronja “ë”, është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “B.... B” me ofertë me vlerë 3,922,842 lekë pa TVSh, ka sjell një mos efektivitet të përdorimit të fondeve buxhetore **në vlerën 204,690 lekë**.

5. Në tenderin me objekt “Mbjellje pemësh dekorative përgjatë shëtitorës Josif Budo”, me kontratë nr. 713/2 prot., datë 03.09.2013 me vlerë 3,198,500 lekë pa tvsh, është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomikë “Shpresa”, pasi në Dokumentet Standarde të Tenderit, tek kriteret për kualifikim nuk është kërkuar paraqitja e certifikatës kontrollit teknik si dokumenti kryesor që përcakton nëse një mjet është në gjendje teknike të rregullt, dhe se data e përcaktuar në lejen e qarkullimit për kontrollin teknik nuk është përcaktuese për vlefshmërinë e këtij veprimi. Nga KVO-ja është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 55, pika 2 “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”, duke i shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kavajë ka sjell një mos efektivitet të përdorimit të fondeve buxhetore **në vlerën 345,340 lekë**

Rekomandimi: Bashkia Kavajë si Autoriteti Kontraktor të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësinë ndaj personave përkatës, për mos përdorimin me efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit, në **5 objektet e sipërcituara në vlerën 5,446,865 lekë**.

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i rekomandojmë Komisionit disiplinor pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për **14 punonjësit**, si më poshtë:

A. “Largim nga Shërbimi civil”

1.znj. A.K, me detyrë Drejtore e Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues në cilësinë e nëpunësit zbatues, për arsye se;

-ka lejuar dhe kryer pagesa të kundërligjshme, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik për vlerën **8 milion lekë**, për vitin 2013 dhe 2014, në fushën e pagave, të arkës, të bankës dhe magazinës.

- ka lejuar krijimin e faturave të palikujduara (kreditore) më datën 31.12.2014 në shumën prej 261,290,142 lekë të mbartura nga viti 2013 e përpara, nga të cilat vetëm vlera prej 22,956,368 lekë janë pasqyruar si kreditorë(borxhe) kurse vlera prej 238,329,720 lekë e cila përfaqëson fatura për Investime të pa likuiduara, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet (në Pasqyrat Financiare të vitit 2014 (Bilancin Kontabël). Nga kjo, vetëm vlera prej 128,917,366 lekë, janë të dokumentuara me fatura, kurse vlera prej 109,375,008 lekë, nuk disponohen fatura, por janë dokumentuar më situacione apo dokument tjetër si; akt rakordimi apo proces verbale, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Pasqyrat Financiare dhe kontabilitetin”

-Edhe pse Bashkia Kavajë ka patur fatura të pa likuiduara nga viti 2012-2013 dhe gjendje të vështirë financiare, ka vazhduar të zhvillojë tenderë dhe lidhur kontrata për vitin 2014 edhe në rreth **25 raste me vlerë 37,342,526 lekë**.

-Në shumën e faturave të pa likujduara mbi 90% e tyre janë punime ndërtimi dhe rikonstruksiione të ndryshme, ku kontratat janë lidhur në vitin 2012 dhe deri më datën 31.12.2014 dhe për mungesë fondesh, ende nuk janë likuiduar 40 objekte ndërtimi në vlerën mbi 224,357,629 lekë.

Kryerja e punimeve shërbimeve apo blerja e mallrave, pa u siguruar fondet nga 96 subjekte duke krijuar një paaftësi pagese në vlerën prej 261,290,142 lekë, **bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50“Angazhimet buxhetore”,**

- Për mos regjistrim në Pasqyrat Financiare të vitit 2014 (Bilancin Kontabël) të vlerës së investimeve prej 128,917,400 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, -Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues, pika 52, 54 dhe pika 60, ku përcaktohet se: bëhet regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre.

-në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është përgjegjëse pasi, nuk i ka përfshirë në buxhet dhe ka pranuar një buxhet të pabalancuar, në kundërshtim me pikën (a) ku përcaktohet se: dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike;

- në cilësinë e nëpunësit zbatues, megjithëse ka ditur gjendjen e faturave të pa likujduara dhe pamundësinë e likuidimit të tyre, bazuar në grumbullimin e taksave vendore, nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 13-Dokumentimi dhe raportimi i urdhrave të kundërshtuar, pika 1.

B.“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, për 12 punonjësit si më poshtë:

1. z. A.M, me detyrë përgjegjës i sektorit të menaxhimit të kontratave,

-Për mos ndjekjen e zbatimit të kontratave për mos hartimin e aktrakordimeve për punimet e kryera dhe faturat e paraqitura, akt marjet në dorëzim të objekteve duke mos kryer likuidimet, nga 5 operatorët ekonomikë edhe pse kishin lidhur kontrata me bashkinë Kavajë që nga viti 2012-2013, ndërkohë nuk kishin përfunduar objektet respektivisht: Operatori ekonomik N. A.Rr sha dhe S... AB” shpk; “E....a” shpk; Ç....’ shpk; “C...” shpk; dhe “K....s”.

- Edhe pse nuk janë zbatuar kushtet e kontratave nuk ka paraqitur një raport për zbatimin e punimeve dhe arsyet e vonesave , duke mos përlllogaritur penalitetet dhe shkelur kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreun e VII-të -Ekzekutimi i Kontratës pika 2. Mbikëqyrja e kontratës, ku përcaktohet se: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet, dhe, në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet, e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62, të LPP-së. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

2.z.Th.D, Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave,

3.z.D.K, Përgjegjësi i Sektorit të menaxhimit të biznesit,

4.znj. S.Sh, specialiste biznesi

5.znj.S.M, specialiste biznesi.

6.z.J.Ç,përgjegjës i sektorit të Borxhit dhe Task-Forcës,

7.z.B.Q,inspektor në terren

8.z.A.P, inspektor në terren

9. z.L.G, inspektor në terren

Për shkeljet e mëposhtme:

- Drejtori i taksave dhe tarifave z. Th.D, nuk ka bërë ndarje detyrash për numrin e subjekteve që mbulon secili punonjës, për pasojë vështirësohet ndarja e përgjegjësisë. Nga ana e Drejtorit Taksave nuk është marrë detyra me proces verbal, ndërkohë nuk është bërë një inventar fizik i dosjeve, me qëllim që të evidentohet dokumentacioni që mungonte, si deklaratat e qarkullimit të xhiros, Njoftim- vlerësimet e detyrimeve tatimore, Regjistrin e tatim paguesve, etj, veprim në kundërshtim me pikat 20 dhe 21 të VKM nr. 360, datë 14.07.2000” Për lirim nga shërbimi civil”.

-Nga puna e pamjaftueshme e bërë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Kavajë e cila numëron rreth 10 punonjës, për pasojë më datën 31.12.2014 për taksat dhe tarifatat

vendore janë debitorë 179 subjekte në **vlerën 16,061,213 lekë**, nga e cila vlera prej 12,850,668 lekë janë detyrime të papaguara ndërsa vlera prej 3,210,545 lekë janë llogaritur interesa për mos pagesa në afat. Nga vlera e debitorëve më datën 31.12.2014 prej 13,315,308 lekë, 42% e tyre ose në vlerën 5,305,180 lekë janë krijuar gjatë vitit 2014, ndërsa 58 % ose në vlerën prej 8,010,128 lekë, u përkasin viteve 2012-2013.

-Nga ana e Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Kavajë në kërkimin e shlyerjes detyrimeve tatimore, është bërë me 2 standarde dhe në mënyrë selektive. Kështu ish-Kryetari i Këshillit Bashkiak Kavajë z. A.A per 2 biznese respektivisht TV 6 dhe aktivitet “Prodhim gozhdësh”, për 3 vjet 2013-2014, nuk ka paguar fare taksën vendore në shumën 540,060 lekë.

-Subjekti “A.” me pronar A.N ka një detyrim për taksën e reklamës në vlerën prej 1,886,800 lekë ose 15% e shumës së debitorëve gjithsejtë, e cila përfaqëson mos pagesën e taksës reklamës për një sipërfaqe prej 150m2 për 2 vitet 2013-2014, ndërkohë që Drejtoria e taksave është mjaftuar vetëm me dërgimin e njoftim vlerësimit, pa dërguar njoftim për bllokimin e llogarisë bankare në bankë, Drejtorinë e Transporteve, ZVRPP apo kallëzim penal.

-Edhe pse subjekti Durim Rroshi ka kryer blerje dhe ka tërhequr 700,000 lekë në Bashkinë Kavajë, ndërkohë nuk i është kërkuar që të paguajë taksën vendore në vlerën 159,240 lekë, i cili me konstatimin nga KLSH kreu arkëtimin e taksës.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka të evidentuar abonentët familjarë të cilët duhet të paguajnë detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit për periudhën 2012-2015.

-Nuk ka kërkuar nga KESH apo Ujësjellës sha Kavajë (ku në këtë të fundit ka 2 anëtarë të këshillit mbikëqyrës), numrin e kontratave të lidhura të cilat janë mbi 6000 të tilla, me qëllim dërgimin e njoftimeve abonentët familjarë, në kundërshtim me pikën nr. 52 të të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”.

-Drejtoria e Taksave nuk u ka dërguar njoftim vlerësim për pagimin e taksës së shërbimit dhe pastrimit 17 Institucioneve Shtetërore, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36 datë 21.11.2014, duke mos arkëtuar për 2 vitet 2013-2014 vlerën e taksave prej 1,670,000 lekë.

-Nga mbikëqyrja e Dosjeve të subjekteve të Biznesit të madh, rezulton se 3 subjekteve nuk u ishin llogaritur detyrimet për taksat vendore, në kundërshtim me nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, ku duhet të paguajnë taksat në vlerën 422,490 lekë së bashku me kamat vonesën prej 105,622 lekë një **detyrim prej 528,112 lekë**, respektivisht: Subjekti E.K, në vlerën 253,050 lekë, Subjekti V.Sh 112,562 lekë dhe Ujësjellësi, sha, Kavajë në vlerën 162,500 lekë.

-Drejtoria e taksave nuk ka aplikuar dënim me gjobë për pagesat e vonuara, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: mospagimi i taksës brenda afatit të caktuar dënohet me gjobë nga 5% në muaj por jo më shumë se 25 % të detyrimit për taksën.

10-D.A, me detyrë Kryeinspektor i IMTV Kavajë, profesion jurist emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. 10, datë 13.07.2011.

11-A.G, Inspektor i IMTV, Shkolla e mesme, Topograf filluar punë më datën 03.01.1997.

12-I,K, Inspektor i IMTV, Shkolla e mesme e përgjithshme filluar punë më datën 15.10.2001,

Për shkeljet e mëposhtme:

- IMTV Kavajë, duke mos patur specialist inxhinier, nuk ka ushtruar kontrolle në zbatim ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe konkretisht të nenit 5 në drejtimet e mëposhtme;
- në drejtim të plotësimit të Dosjes objektit me dokumentacionin e nevojshëm, teknik dhe ligjor.
- për zbatimin e kushteve teknike në ndërtim.
- nuk ka ushtruar kontrolle në teren, për zbatimin e 36 Lejeve të shfrytëzimit të dhëna për vitet 2013-2014.
- nuk kanë ushtruar asnjë kontroll për objektet që ka dhënë Lejë ndërtimi, në drejtim të mbajtjes akteve të piketimit, akti i përfundimit të themeleve, akti i përfundimit të karabinasë.
- nuk kanë ushtruar asnjë kontroll në drejtim të marjes së masave të sigurimit teknik dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve, krijimit të kushteve sipas Kodit Punës.
- IMTV Bashkia Kavajë për 2 vitet 2013-2014 nuk ka hartuar plane mujore për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të Bashkisë, siç përcaktohet në pikën 1/ii të VKM nr. 862, datë 5.12.2007“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor.”
- Edhe pse për periudhën 2 vjeçare 2013-2014 janë dhënë 15 lejë shfrytëzimi dhe 50 Lejë zhvillimi të cilat kana filluar dhe një pjesë e tyre kanë përfunduar punimet apo janë në proces,ndërkohë nuk kanë dorëzuar në IMTV Kavajë, dosjen me dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me pikën 11.3 dhe 11.2 të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I-Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit.
- Edhe pse **50 subjektet** të cilat janë pajisur me lejë zhvillimi , nuk kanë njoftuar përpara fillimit të punimeve në seksionin e urbanistikës (autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit") dhe inspektoratin ndërtimor e urbanistik, në nivel bashkie/ komune/qarku. Shkelje të cilat sipas neneve 9 dh 11 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 përbëjnë kundërvajtje administrative, ndërkohë nga Kryeinspektori i IMBV, z. Dritan Agushi bazuar në nenin 16 pikën 2 po të këtij ligji, nuk ka dënuar zbatuesit e punimeve me gjobë në masën 50 000 deri në 500 000 lekë.
- IMTV Kavajë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban nuk kanë bashkëpunuar ndërmjet tyre në zbatim të detyrave të përcaktuara në neni 81-Inspektimi, pika 3 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.
- Aktet e nxjerra nga INUV Kavajë, si proces verbale konstatimi, akte pezullimi, vendime prishje, vendime gjobe nuk janë pasqyruar në Regjistër për vitet 2013-2014 dhe të mbartura nga vitet e mëparshme, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar neni 81-Inspektimi, pika 4 ku përcaktohet se: Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.
- Nga INUV dhe Drejtoria e Planifikimit Urban nuk kanë hartuar dhe paraqitur raportet vjetore mbi zhvillimin në territor, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar neni 81-Inspektimi, pika 5 ku përcaktohet se: Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor mbi zhvillimet në territor.
- Për 46 prishjet e ndërtimeve të kundërligjshme nuk janë vendosur gjoba, ndërkohë që në dosje duhet të kishte gjurmë për propozimet e vetë Inspektorëve të cilët kanë konstatuar kundërvajtjet, mos propozimi i vendosjes së gjobave nga inspektorët është në kundërshtim VKM nr. 862 datë 05.12.2007 ”Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor”, pika 8, ku përcaktohet se:

Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzim penal për kundrvajtjesin.

-Megjithëse kanë kaluar mbi 4 vjet, nga data e dërgimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën 586/10, datë 29.08.2011, nga z. D.A, Kryeinspektor i IMTV-së, nuk janë nxjerrë fare vendimet e gjobave, në vlerën 400,000 lekë, respektivisht ndaj: Subjektit “D... -E” sh.p.k. i përfaqësuar nga z. B.D në masën 200,000 lekë dhe 4 mbikëqyrësit e tjerë me nga 50,000 lekë gjobë secili, respektivisht Th.D, P.P dhe N.Baçi, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007”Për Inspektimin e Ndërtimit” neni 13 -Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet.

-Për periudhën Gusht 2011-2013 nga ana e Kryeinspektorit të IMTV Kavajë , nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit të gjobave, nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu kontabilizuar 10 vendimet e gjobave për shumën 3,850,000 lekë + kamat vonesa në vlerën 2,310,000 lekë = 6,160,000 lekë, në kundërshtim me dispozitat ligjore të mëposhtme;

a) ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore , bazuar në nenin 16 ku parashikohet se; Gjopa paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

b)ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” përkatësisht nenet, 9,22 dhe 30 të cilat në mënyrë eksplicite përcaktojnë:

1)-neni 9 “Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative” ku parashikohet se: Kur organi administrativ ka nxjerr vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor.

3) -neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve”

4. Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht, nga:

a)-kryetari i bashkisë apo komunës.

II. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i rekomandojmë Komisionit disiplinor pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, që nga masa **“Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për 14 punonjësit**, si më poshtë:

1. znj. S.P, me detyrë përgjegjëse e drejtorisë ligjore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos ndjekjen e zbatimit të kontratave, çka ka krijuar vlerën 1,700,000 lekë dëm ekonomik, detyrim kontraktor për mos pagesën e taksës tregut dhe parkimit nga agjentët privat për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me kontratat nr. 1473 datë 16.01.2013, nr. 1651 datë 31.12.2013, nr. 1472 datë 16.01.2013, nr. 1650 datë 31.12.2013, nr. 1471 datë 16.01.2013 dhe nr. 1474 datë 16.01.2013. Për anomali në hartimin e kontratave të tregut dhe parkimit, pasi nuk përcaktohen penaltetet, kontratat nuk shoqërohen harta e skica sipas shesheve dhe vendeve, për sipërfaqen dhe numrin e tregtarëve e automjeteve, dokumente bazë për saktësinë e vendosjes të vlerës në kontratë.

- Për krijimin e pa nevojshme të disa drejtorive, apo funksioneve çka ka bërë që disa punonjës të mos kenë ngarkesën e duhur në punë, të cilët nuk justifikojnë ngarkesën e punës etj.

-Për disa emëtime në pozicione pune të pajustificuara si, përgjegjësi i njësisë prokurimeve, përgjegjësi i sektorit biznesit e ardhurave, përgjegjësi i borxhit, përgjegjësi i menaxhimit kontratave, përgjegjësja e sektorit juridik, përgjegjësia e arkiv protokollit dhe përgjegjësja e sektorit marrëdhënieve me publikun.

-Për marrjen në punë të disa punonjësve pa ju nënshtruar procesit të konkurrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusit i Nëpunësit Civil i ndryshuar” i ndryshuar, nenin 13 “Pranimi”, pika 1.

2. znj.P.M, me detyrë llogaritare e magazinës, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e krijimit të vlerës 592,787 lekë dëm ekonomik, për karburant të pajustificuar, pasi pa bazë ligjore është bërë furnizim për disa punonjës të bashkisë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

-Për 2 standarde të përdorura në furnizimin me bileta për taksën veterinere për vitet 2013 dhe 2014, pasi janë prerë mandat pagesa me vlerën e paketës fiskale dhe janë prerë fletëdalje me vlerën e bllokut biletave në vend të vlerës sipas paketës fiskale.

-Për mos administrim dhe mos kontabilizim të biletave për taksën veterinere, parkimit e tregut, për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi për vitin 2013, inspektori i taksave vendore ka prerë mandatpagesa, për furnizimin me bileta për veterinerin, në vend të arkëtares bashkisë, ndërsa për vitin 2014 biletat për taksën veterinere janë bërë dalje nga magazinieri me vlerën e bllokut biletave, në vend të vlerës taksës veterinere të miratuar në KB.

- Nuk ka rekordim vjetor mes financës dhe veterinerit, për biletat e shitura dhe arkëtimet e tyre dhe për gjendjen e biletave të pa shitura. Mandatpagesat janë prerë me vlerën sipas paketës fiskale dhe nuk janë regjistruar në kontabilitet.

-Për mos bërjen hyrje të 154 copë pemëve dekorative Manjola për vlerën 2,907,828 lekë (mbi 2 metra lartësia dhe 20 cm diametri të Buna shpk), sipas urdhër shpenzimit nr. 564, datë 17.10.2014, për efekt të administrimit dhe inventarizimit tyre, në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

3. R.G, me detyrë specialist i pagave, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e pagesave të paligjshme të disa këshilltarëve bashkiak, nën mungesën e listë prezencës, të cilët nuk kanë marrë pjesë mbledhje KB për vitin 2013 dhe 2014, çka ka krijuar vlerën 1,154,790 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

-Për dhënie page për vështirësi pa mbështetje ligjore në 4 raste për vlerën 562,800 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për mos mbajtjen e librit të pagave për vitin 2014.

4-znj.V.B., me detyrë llogaritare e të ardhurave, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e krijimit të detyrimit kontraktin për vlerën 1,700,000 lekë dëm ekonomik, për mos pagesën e taksës tregut dhe parkimit nga agjentët privat, për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me kontratat nr. 1473 datë 16.01.2013, nr. 1651 datë 31.12.2013, nr. 1472 datë 16.01.2013, nr. 1650 datë 31.12.2013, nr. 1471 datë 16.01.2013 dhe nr. 1474 datë 16.01.2013.

-Për lejimin e 2 standardeve në furnizimin me bileta për taksën veterinere për vitet 2013 dhe 2014, pasi janë prerë mandat pagesa me vlerën e paketës fiskale, të pa regjistruara në kontabilitet dhe me fletëdalje me vlerën e bllokut biletave në vend të vlerës sipas paketës fiskale.

5-znj.T. D, me detyrë supervizore e pastrimit, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësi në mbajtjen e situacioneve dhe procesverbaleve ditore për pastrimin e qytetit, për 9-mujorin e vitit 2013, çka ka ndikuar në zbritjen e volume të pakryera ose të kryera pa cilësi si dhe mos aplikimin e penalteteve ndaj firmës sipërmarrëse, në kundërshtim me nenin 8 “Mbykqyrësi i shërbimit” të kontratës pastrimit datë 31.5.2013 si dhe me nenin 15 etj.

-Për lejimin e pagesës së zërit “Heqje e mbetjeve solide e inerte” në situacionet e firmës sipërmarrëse, në kundërshtim me Kreun II-të, neni 5 “Mbeturinat” dhe Kreun III të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, për rrjedhojë është likuiduar vlera 1,400,000 lekë dëm ekonomik për vitin 2013 e 2014.

-Për mos zbritjen në situacionet e firmës sipërmarrëse të pastrimit, të zërit “Lagie rrugë e sheshe”, i cili nuk parashikohet për periudha dimërore përkatësisht në muajin tetor dhe dhjetor 2013, çka ka krijuar vlerën 237,150 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me kontratat e pastrimit.

-Për mos dokumentimin e punës për 66 punëtorët e pastrimit, sipas normave ditore për secilin, për zërin “fshirje rrugë”, por është mjaftuar vetëm me mbajtjen e listprezencave mujore.

6- E.B, me detyrë ish-Drejtor i Planifikimit të Territorit larguar me datë 01.10.2013;

- Për mos zbatimin e kërkesave ligjore në hartimin dhe miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, veprim në papajtueshmëri me neni 3, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

Në miratimin e lejeve zhvillimore të ndërtimit në objekte private dhe publike, pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor janë pa fuqi ligjore, veprim në papajtueshmëri me nenin 4, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

- Për mos ngritjen e Këshillit Teknik, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” dhe neni 45, të KVKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit”.

- Për mos funksionimin e Regjistrit të Territorit të Planifikimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 51, 52, pikën 2 të nenin 53, 56, 57 dhe 58, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit” dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të planifikimit të territorit”.

- Për mos funksionimin e portalit Web të sistemit GIS, veprim në papajtueshmëri me nenin 52, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”.

- Për mos dërgimin brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të plotë të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, në kopje shkresore dhe në version elektronik në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 70/12, të ligjit nr. nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e informacionit dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokës në Agjencinë Kombëtar të Planifikimit të Territorit, veprim në papajtueshmëri me pikën 4 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e raportit vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Tiranë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar
- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 6 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

- Për mos plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për 13 raste, lejet zhvillimore ndërtimi në infrastrukturë për objekte publike për vitin 2013, dokumentacion i cili u kërkuar dhe nuk ndodhet në arkivin e Urbanistikës, veprim në papajtueshmëri me neni 70, të ligjit nr. 10119, datë 29.03.2011 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

7- J.M, me detyrë ish-Drejtor i Planifikimit të Territorit larguar nga detyra me datë 13.05.2014, aktualisht specialist në Drejtor i Planifikimit të Territorit;

- Për mos zbatimin e kërkesave ligjore në hartimin dhe miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, veprim në papajtueshmëri me neni 3, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

Në miratimin e lejeve zhvillimore të ndërtimit në objekte private dhe publike, pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor janë pa fuqi ligjore, veprim në papajtueshmëri me nenin 4, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

- Për mos ngritjen e Këshillit Teknik, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” dhe neni 45, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit”.

- Për mos funksionimin e Regjistrit të Territorit të Planifikimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 51, 52, pikën 2 të nenin 53, 56, 57 dhe 58, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit” dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të planifikimit të territorit”.

- Për mos funksionimin e portalit Web të sistemit GIS, veprim në papajtueshmëri me nenin 52, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”.

- Për mos dërgimin brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të plotë të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, në kopje shkresore dhe në version elektronik në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 70/12, të ligjit nr. nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e informacionit dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokës në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, veprim në papajtueshmëri me pikën 4 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e raportit vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Tiranë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar

- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 2 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë

01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

8- F.L, me detyrë Drejtore e Planifikimit të Territorit nga data 13.05.2014;

- Për mos zbatimin e kërkesave ligjore në hartimin dhe miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, veprim në papajtueshmëri me neni 3, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

Në miratimin e lejeve zhvillimore të ndërtimit në objekte private dhe publike, pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor janë pa fuqi ligjore, veprim në papajtueshmëri me nenin 4, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar.

- Për mos ngritjen e Këshillit Teknik, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” dhe neni 45, të KVKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit”.

- Për mos funksionimin e Regjistrit të Territorit të Planifikimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 51, 52, pikën 2 të nenin 53, 56, 57 dhe 58, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit” dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të planifikimit të territorit”.

- Për mos funksionimin e portalit Web të sistemit GIS, veprim në papajtueshmëri me nenin 52, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”.

- Për mos dërgimin brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të plotë të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, në kopje shkresore dhe në version elektronik në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 70/12, të ligjit nr. nr. 110, datë 01.04.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e informacionit dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokës në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, veprim në papajtueshmëri me pikën 4 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

- Për mos dërgimin e raportit vjetor në lidhje me çështjet administrative të territorit në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Tiranë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 të nenit 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar

- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 6 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

- Për mos plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor në 7 raste, lejet zhvillimore ndërtimi në infrastrukturë për objekte publike për vitin 2014, dokumentacion i cili u kërkua dhe nuk ndodhet në arkivin e Urbanistikës, veprim në papajtueshmëri me neni 70, të ligjit nr. 10119, datë 29.03.2011 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

9- znj.F.K, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të urbanistikës;

- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 4 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë

01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

10- A.H, me detyrë specialiste;

- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 2 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

11- D.A, me detyrë specialist;

- Për mos zbatimin e kondicioneve urbane të strukturës ndërtimore për objekte private nga kufiri i pronës në 4 raste, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

12- E.F, me detyrë specialist i ngarkuar për mbajtjen e Regjistrit të Territorit.

- Për mos funksionimin e Regjistrit të Territorit të Planifikimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 51, 52, pikën 2 të nenin 53, 56, 57 dhe 58, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, ku përcaktohet:”Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit” dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të planifikimit të territorit”.

- Për mos funksionimin e portalit Web të sistemit GIS, veprim në papajtueshmëri me nenin 52, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”.

13- E.C, me detyrë veterinerë dhe

14- B.L, me detyrë veteriner, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim të taksës veterinerë për vitin 2013 për 65,000 lekë mungesë të ardhurash dhe 145,000 lekë mungesë të ardhurash për vitin 2014.

-Për veprime me 2 standarde në furnizimin me bileta për taksën veterinerë për vitet 2013 dhe 2014, me mandat pagesa me vlerën e paketës fiskale dhe të pa regjistruara në kontabilitet dhe me fletëdalje me vlerën e bllokut biletave në vend të vlerës sipas paketës fiskale.

II. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Kavajë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Zgjidhjen e Kontratës të Punës”, për;

1.zj.M.P Drejtore Ligjore, për mos përmbushjen e detyrave funksionale, si më poshtë:

-Për mos kërkimin në rrugë ligjore të rekomandimeve dërguar me shkresën nr.70/7 Prot, datë 29.04.2013, të rikërkua me shkresën nr. 687, datë 01.07.2013 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, konkretisht:

1-Në cilësinë e Drejtores Ligjore, ka kërkuar pranë Këshillit Bashkiak Kavajë që aktet e nxjerra nga KLSH, nuk përbëjnë akte administrative dhe si të tillë nuk janë të detyrueshme për tu zbatuar, për pasojë Bashkia Kavajë, nuk ka kryer kontabilizimet për arkëtimin e

vlerës 15,030,092 lekë, duke vepruar dhe për interesa të caktuara, pasi dhe në rekomandimet e KLSH, ku kanë përfituar padrejtësisht subjekte private (për punime të pakryera) i ka marrë në mbrojtje, pa kryer asnjë procedurë ligjore apo administrative, duke mos përmbushur detyrimin ligjor ndaj institucioneve kushtetuese e bërë palë me shkelësit e ligjit.

Nuk ka marrë pjesë në procesin gjyqësor që është zhvilluar për këtë çështje (me argumentimin se ka qenë e angazhuar me gjyqe të tjerë, kur shumë mirë mund të pajisnin me autorizim një jurist tjetër) dhe nuk ka vazhduar procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit ekonomik edhe pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9858, datë 04.10.2013, ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr.16970 akti, që i përket paditësit Bashkia Kavajë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. regjistri 53114, datë 23.06.2014 me numër vendimi 3237 datë 23.07.2014 ka lënë në fuqi vendimin nr. 9858, datë 04.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpallur më datën 23.07.2014 **vendim i cili është i formës prerë**, si më poshtë:

a. në vlerën 12,788,587 lekë ndaj 5 antarëve të KVO-së, pasi kanë skualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë me ofertë më të ulët, **duke i shkaktuar dëm ekonomik bashkisë, në vlerën 12,788,587 lekë, në 8 tenderët** me objekt: - Rikonstruksioni i rrugës Pal Xhumari në vlerën 475,902 lekë, Rrugës Kosova 1,424,304 Rrugës Varrezave 1,206,472 lekë, Rrugës Josif Budo 2,878,699 lekë, Rrugë A. Stefi 97,795 lekë, Rrugës Luleve 67,498 lekë, R. Sukaj 724,147 lekë dhe objekti ngritje Kati bashkia Kavajë në vlerën 5,913,770 lekë.

b. në vlerën 2,241,505 lekë ndaj 4 antarëve të Njesisë së prokurimit në cilësinë e hartuesve të preventivit, në tenderin me objekt "Rikonstruksion dhe ngritje kati" i godinës së bashkisë, vlerën 2,241,505 lekë, për shkak se kanë rritur padrejtësisht fondin limit, në papajtueshmëri me analizat teknike për punimet e ndërtesave të Manualit 2 të miratuar me VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" .

-Për mos ndjekjen e procedurave ligjore edhe për vlerën e mbetur prej 6,305,928 lekë e cila përfaqëson mos arkëtimin nga 12 subjekte për punime të pakryera apo dëm ekonomik - Për mos kërkimin e nxjerrjes së titullit të ekzekutimit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Kavajë, respektivisht, të gjobave të vendosura nga IMTV Kavajë për vlerën **200,000 lekë** respektivisht

-Për lejimin e lidhjes së kontratave për administrimin e tregut dhe parkimit me agjentët privat të pabazuara në dispozita ligjore apo nënligjore, duke cenuar interesat e Bashkisë Kavajë, me pasojë krijimin të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën **1,700,000 lekë**.

III. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nnrit 10 të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Kavajë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për 12 punonjësit e mëposhtëm:

- 1- z. I.Rr, me detyrë Përgjegjës i Policisë Bashkiake nga data 19.11.2013-në vazhdim,**
- 2- A. K me detyrë polic bashkiak nga data 18.07.2011-02.05.2013**
- 3- S.F me detyrë polic bashkiak nga data 15.08.2011-në vazhdim,**
- 4- K.L me detyrë polic bashkiak nga data 05.03.2012-në vazhdim,**
- 5- S.Sh me detyrë polic bashkiak nga data 02.09.2011-në vazhdim,**
- 6- A.A, me detyrë polic bashkiak nga data 01.11.2011-në vazhdim,**
- 7- D,T në detyrë nga data 01.05.2013-në vazhdim,**
- 8- E.F në detyrë nga data 06.01.2014 deri në datë 22.08.2014,**

9- A. M, në detyrë nga data 22.11.2012-në vazhdim,

10- H.G, në detyrë nga data 19.06.2014-në vazhdim.

Për shkeljet e mëposhtme:

a- Kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për “Shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393 datë 18.06.2014 pika 2, pasi janë shfaqur probleme të theksuara në administrimin e blloqeve të gjobave të Policisë Bashkiake.

b- Për mos nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e gjobave deri në datë 31.12.2014, dhe mos regjistrimin e tyre në kontabilitet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 si dhe të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 44-“Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”.

c- Për mos bashkëpunim dhe punë pa përgjegjësi të Policisë Bashkiake me Sektorin e Tatim Taksave në drejtim të evdientimit të subjekteve debitore dhe subjekteve të paregjistruara duke mos respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar dhe ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8385, datë 23.04.1998 "Për policinë bashkiake e të komunës", neni 8, pika 3 dhe Rregullores Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake e të Komunës të miratuar me Urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr. 1 datë 17.04.2003, Kreu V “Detyrat dhe të drejtat”, neni 13, pika 3.

ç- Për mos kryerje detyre, pasi Policia Bashkiake më tepër është marë me vendosjen e gjobave për parkime të gabuara edhe këtu me 2 standarte 1 mjeti i kanë vendosur gjobën në masën 5000 lekë, një mjeti tjetër po në të njëjtat shkelje i kanë vendosur masën e gjobës 5,000 lekë.

11. Sh.B, me detyrë drejtore e kopshtit,

12. A.C, me detyrë drejtore e çerdhes, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejin e krijimit të disa personave debitor për trajtim me ushqim pa arkëtuar më parë detyrimin e prapambetur, çka ka bërë që të shtohet vlera debitorë për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për mos shoqërim të flet daljeve ushqimore me përmbledhësen mujore, për efekt të administrimit të shpenzimeve ushqimore.

C. MASA ADMINISTRATIVE

c. 1 Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Kombëtar:

Mbështetur në nenin 5/b, 9/b, n9/1 pika 1/a, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.12.2014, nenin 15”Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Kombëtar, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë sanksionet në raport me këto shkelje, respektivisht;

I- Ndaj investitorit Bashkia Kavajë, për pajisjen me lejë zhvillimore për 3 objektet e mëposhtme duke qenë se kanë vlerën e preventivuar mbi kufirin e përcaktuar prej 100,000,000 lekë dhe mos bërjen e kërkesës për kryerjen e oponencës teknike.

II- Ndaj projektues-preventivues, Studio “E....” shpk me NUIS- K 31705131E me seli në Tiranë dhe Studio “I..., për mos kryerjen me cilësi të projekt-preventivit në Objektin Rikonstruksioni i sheshit të Xhamisë Kubelije (Rikonstruksioni i Shëtitores “Josif Budo dhe lulishte “Indrit Cara” me vlerë të preventivuar 202,694,304 lekë.

III-Ndaj z.F.H, përfaqësues i subjekteve studio projektuese “I...” sh.p.k. & “E....” sh.p.k., me detyrë projektuesit e objektit.

I.Nga auditimi rezultoi se 3 objektet e mëposhtme edhe pse janë pajisur me lejë zhvillimore, nuk u është kërkuar kryerja e oponencës dhe konkretisht:

1. Objekti: Rikonstruksioni i rrugës dalëse “Princi Topia” Faza e I-rë me vlerë 199,991,129 lekë, me tvsh, Leja zhvillimore e infrastrukturës, është miratuar me vendimin e kryetarit të Bashkisë Kavajë nr.15,datë 26.08.2014, protokolluar në zyrën e arkivit Bashkisë Kavajë me shkresën nr. 1371, datë 26.08.2014.Leja i jepet Zhvilluesit: G...Company shpk, me afat kohor deri më datën 23.03.2015.

2. Objekti Rikonstruksioni i sheshit të xhamisë Kubelije (Rikonstruksioni i Shëtitores “Josif Budo dhe lulishte “Indrit Cara” me vlerë të preventivuar 202,694,304 lekë, me tvsh. Sipas kontratës (pa shpërblim) nr. 810, prot datë 06.08.2013 të lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe Studio “E....” shpk me NUIS- K 3.....1E me seli në Tiranë dhe Studio “I.... Studio” shpk me NUIS - K A.

3. Rikonstruksioni i rrugës Tironsave (Rruga hyrëse e qytetit) Faza e II-të, me vlerë të preventivuar 190,797,474 lekë, me tvsh projektues dhe preventivues Studio “E....” shpk me NUIS- KE me seli Tiranë dhe Studio “I.....” shpk me NUIS - KA.

Pajisja me lejë zhvillimore nga ana e kryetarit të Bashkisë z. Elvis Rroshi, pa u kryer më parë oponenca teknike për këto 3 objekte, duke qenë se kanë vlerën mbi 100,000,000 lekë, është vepruar në kundërshtim **me dispozitat ligjore të mëposhtme :**

a) ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" neni 6 ku përcaktohet se: -Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.

b) VKM nr.363, datë 18.7.2002 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet”, ku përcaktohet se:

1. Për të gjitha projektet e ndërtimit të objekteve, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj vlera e preventivuar e të cilave është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike.

2. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve të bëhet nga institutet studimore, shtetërore në varësi të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Kjo ministri, në raste të veçanta, mund të autorizojë, në bazë të kritereve të përcaktuara paraprakisht edhe institute ose ente të tjera publike.

3. Kërkesa për oponencë teknike në institutet shtetërore dhe institucionet a entet e tjera jopublike, të përcaktuara nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, të bëhet nga investitori.

II- Ndaj projektues-preventivues, Studio “E....a” shpk me NUIS- KE, Tiranë dhe Studio “I....t Studio, për mos kryerjen me cilësi të projekt-preventivit në Objektin Rikonstruksioni i

sheshit të Xhamisë Kubelije (Rikonstruksioni i Shëtitores “Josif Budo dhe lulishte “Indrit Cara” me vlerë të preventivuar 202,694,304 lekë.

Mbi hartimin pa cilësi të projekt-preventivit të Objektivit Rikonstruksioni i sheshit të xhamisë Kubelije (Rikonstruksioni i Shëtitores “Josif Budo dhe lulishte “Indrit Cara” me vlerë të preventivuar 202,694,304 lekë, pasi sipas të dhënave të paraqitura rezulton se:

Në preventivin e mëparshëm të Objektivit Rikonstruksioni i sheshit të Xhamisë Kubelije (Rikonstruksioni i Shëtitores “Josif Budo dhe lulishte “Indrit Cara” me vlerë të preventivuar 202,694,304 lekë, për ujërat e parashikuar në 8 zëra punimesh për Ujësjellës -Kanalizim i jashtëm dhe drenazhimet në vlerën prej 6,837,200 lekë, ndërsa në Preventivin e ripunuar rezulton se shuma e kanalizimeve për ujërat e zeza dhe ujërat e bardha arrin në vlerën prej 19,155,010 lekë, ose me një diferencë më pak prej **12,317,810 lekë.**

Sa sipër kemi mos zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" Kreu III-të, Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit, neni 5 ku përcaktohet se: Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit.

III. Ndaj z.F.H, përfaqësues i subjekteve studio projektuese “I....” sh.p.k. & “E...” sh.p.k., me detyrë projektuesit e objektit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Nga mos kontrolli i çmimeve të pasqyruara në preventivin e ripunuar dhe pranimin e gabuar të çmimeve për 5 zëra punimi me pasojë rritjen artificiale të vlerës së preventivit të ripunuar duke i shkaktuar një impakt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Kavajë prej 3,614,060 lekë.

Bashkia Kavajë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ka miratuar ndryshimin e volumeve për objektin “Rikonstruksion i shëtitores “Josif Bundo” dhe lulishtës “Indrit Cara””, Bashkia Kavajë dhe nuk ka ngritur grup pune për të bërë negocimin e çmimeve për zërat e rinj të punimeve, gjithashtu nuk ka kontrolluar çmimet e pasqyruara në preventivin e ripunuar, të cilat janë përcaktuar sipas analizës së çmimit, nga ku u konstatua se nga përlllogaritja e gabuar e çmimeve për 5 zëra punimi (të pasqyruar në tabelën e mëposhtme), për përcaktimin e vlerës së preventivit të ripunuar, rezulton se vlera e preventivit të ripunuar është rritur në mënyrë fiktive duke i shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Kavajë, në vlerën 3,614,060 lekë. Veprim apo mos veprim në kundërshtim me:

a. shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5, neni 33, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

b. shkronjën “a”, paragrafi 9, pika 5, kreu IV, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

c. Udhëzimi i KM Nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe me pikën 8.1, kreu II, të Udhëzimit KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës,

c.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, dhe pikat 9, 10 dhe 14, të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe

Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces verbalet nr. 05, datë 13.05.2015, nr.25, datë 15.05.2015, nr. 26, datë 13.05.2015, nr. 27, datë 29.05.2015 dhe nr. 33, datë 25.05.2015 dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ”Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar dhe nenin 15”Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Kavajë që, të vlerësojë shkeljet** e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për 4 mbikëqyrësit dhe 2 kolaudatorët e punimeve si më poshtë;

1.L.P, nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i trotuareve të anës perëndimore të shëtitores Josif Bundo” me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale 2,278,496 lekë pa T.V.SH;

2.F.V, nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Gjergo” me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale 1,044,559 lekë pa T.V.SH;

3.Gj.P, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 1462/1, për shkeljet në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i rrugës së “Serave” dhe rrugës “Mësuesi”. Si rezultat i situacionimit të 9 zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën 420,247 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “E...” sh.p.k.

4. F.Ç, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 0648, për shkelje në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i rrugës “Pal Xhumari.

a.Si rezultat i situacionimit të njëmbëdhjetë zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën 1,133,780 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “S..” sh.p.k.

b- Janë përdorur materiale për ndërtimin e objektit, që nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara dhe nuk janë kryer në masën e duhur testimet dhe provat laboratorike të këtyre materialeve të vendosura në objekt.

5.F.K, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i trotuareve të anës perëndimore të shëtitores Josif Bundo” me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **2,278,496 lekë pa T.V.SH;**

6.I.D, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Gjergo” me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1,044,559 lekë pa TVSH**

c. 3. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “i”, të nenit 13 Agjencia e Prokurimit Publik, nenit 72 Kundërvajtjet administrative, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 1, të nenit 79

Sanksionet administrative, pikave 1 dhe 2 të nenit 81 Masat disiplinore, të kreut X Sanksionet administrative dhe masat disiplinore të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për personat e mëposhtëm:

A.Për prokurimet publike të vitit 2013

1.E.B, kryetar i KVO, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave,

2.Th.D, anëtar, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore

3.A.M, anëtar, me detyrë Specialist i Nivelit të Lartë për Supervizim Shërbimesh.

Për shkeljet e mëposhtme:

1-Në të 16 procedurat e kontrolluara dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomikë fitues nuk janë në përputhje me kërkesat e vendosura në DST, KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” (Më hollësisht trajtuar në proces verbalet nr. 5, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 30, 42, 43, 46)

2- Në 2 raste është konstatuar trajtim i pabarabartë në procedurat e prokurimit “Ndriçimi i shëtitores Indrit Cara”, me kontratë nr. 758/2 prot, datë 19.08.2013 me vlerë 5,659,227 lekë pa tvsh, “Rikonstruksion i Rugës Dhimitër Pjeshkazini” me kontratë nr. 711/2 prot, datë 10.07.2013 me vlerë 3,790,904 lekë pa tvsh, (Më hollësisht trajtuar në proces verbalin nr. 30, datë 14.05.2015 dhe nr. 42, datë 28.05.2015)

3-Në një rast janë shmangur procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant duke lidhur kontratën me nr. 460/4 prot, datë 12.08.2013 me subjektin “Inter-Alb Oli” Sh.a me vlerë 1,340,833 lekë pa TVSh dhe 1,609,000 lekë më TVSh. Para lidhjes së kësaj kontrate nuk është zhvilluar procedura dhe nuk është mbajtur asnjë dokument tjetër, duke u shkelur haptazi kërkesat e ligjit

nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1 Objekti dhe qëllimi, pika 1. dhe pika 2, shkronja “b”.

4.Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës” në tenderin me objekt “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Kavajë” me kontratë nr. 151/1 prot, datë 08.02.2013 me vlerë 845,833 lekë pa tvsh, rezultoi se, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, pasi janë ndryshuar kushtet fillestare të kontratës apo të dokumenteve të tenderit, kapaciteti ekonomik financiar dhe teknik (Më hollësisht trajtuar në proces verbalin nr. 11, datë 14.05.2015)

5.Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i Pastrimit qytetit Kavajë” viti 2013 nuk janë respektuar afatet për dorëzimin e dokumenteve të tenderit në kundërshtim me Nenin 43, pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara ka penguar marrjen pjesë në tender të operatorëve të tjerë.

-Edhe pse për të 2 vitet 2013-2014 për pastrimin e qytetit me procedurën “Negocim pa shpallje paraprake” me operatorin ekonomik “K...” Sh.p.k janë lidhur 6 kontrata në vlerën gjithsejtë prej 22,658,317 lekë, pa tvsh, në asnjë vit të 2 tenderat e pastrimit nuk janë dërguar në APP për tu botuar në regjistrin e parashikimeve dhe realizimin e prokurimeve, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, i ndryshuar, Kreu I- Organizimi i prokurimit publik, pika 3 Buletini i Njoftimeve Publike, -Shkronja b) Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik dhe d) Raportimi i realizimeve të prokurimit publik.

6-Nga autoriteti kontraktor në lidhjen e kontratës së re, për pastrimin e qytetit, nr. 528/4 prot, datë 30.08.2013, me vlerë 4,741,847 leke pa TVSh janë shkelur haptazi kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1 Objekti dhe qëllimi, pika 1, 2, shkronja “b”(Më hollësisht trajtuar në proces verbalin nr. 46, datë 28.05.2015)

B.Për prokurimet publike viti 2014

1.z.E.R titullari i autoritetit kontraktor kryetari i bashkisë Kavajë

Njësia e prokurimit e përbërë nga;

2.z.E.A, Jurist me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve,

3.z. M.D, Juriste, me detyrë Specialiste e Njesisë së Prokurimit

4.znj.A.H, specialiste inxhinere Ndërtimit në Drejtorinë e Kontrollit dhe Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave.

Antarët e KVO

1.I.Sh, kryetare e KVO, Drejtore e Kabinetit, me profesion, arkitekte,

2.A.M, antar i KVO me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Kontratave.

3.D.K, antar i KVO, Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të Biznesit (ekonomist).

-Në 3 tendera më vlera të konsiderueshme u konstatuan mos plotësim i dokumentacionit të përcaktuar në kërkesat për kualifikim dhe në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vazhdonte procesin e përzgjedhjes së fituesit dhe tenderi duhej të përsëritej, të analizuar për secilin tender paraqiten më poshtë:

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt: Rikonstruksioni i rrugës dalese (Princat Topia) zhvilluar në vitin 2014, Tender i Hapur Fondi limit 166,659,274 lekë pa tvsh Firma fituese G.. shpk, vlera kontratës 162,391,930 leke pa tvsh, diferenca nga fondi limit 4,267,344 lekë.

Me shkresën nr.970/2, datën 30.06.2014, ose 3 ditë para hapjes së tenderit, autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentet e tenderit dhe tenderi hapet datë 8.7.2014.

Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit nuk ishte hartuar proces verbal i cili duhej të nënshkruhej nga të 3 antarët e komisionit të vlerësimit ofertave. Për sa me sipër Njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me:

a. ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar respektivisht:

a. neni 23-specifikimet teknike pika 2, ku përcaktohet se: Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

b. VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar,:

Për arsye të mos plotësimit të 3 kërkesave për kualifikim Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vlerësonte dhe klasifikonte ofertën e operatorit ekonomik “GPG Kompany”.

Në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vazhdonte procesin e përzgjedhjes së fituesit dhe tenderi duhej të përsëritej, pasi është vepruar në mospërputhje VKN nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

2. Për tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Tironsave (rruga hyrëse e qytetit)” zhvilluar në vitin 2014, tender i Hapur , Fondi limit 158,997,895 lekë pa tvsh, Firma fituese G.. shpk , vlera kontratës 158,647,680 leke pa tvsh, diferenca nga fondi limit 350,215 lekë .Preventivi për llogaritjen e fondit limit është hartuar nga shoqëria I.... Studio, në preventiv janë

parashikuar të vendosen ndriçues shtyllë me vlerë gjithsej rreth 10 milion lekë, por nuk është parashikuar vendosja e shtyllave se ku do vendosen ndriçuesit.

Me shkresën e autoritetit kontraktor me nr.1780/2, datë 2.12.2014, modifikohen dokumentet e tenderit (preventivi i punimeve i azhornuar), por pa shprehur arsyet e këtij modifikimi. Afati shtyhet me 5 ditë.

Nga auditimi rezultoi:

1.Operatori ekonomik “G...”. Nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë sipas kërkesave për kualifikim

2.Operatori ekonomik “A....Impex G”, në mospërputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit:

Në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vazhdonte procesin e përzgjedhjes së fituesit dhe tenderi duhej të përsëritej, pasi është vepruar në mospërputhje VKN nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”,

3. Në tenderin e zhvilluar me objekt: Rikonstruksioni i shëtitores “Josif Budo” dhe Lulishtes “Indrit Cara”, Tender i Hapur, fondi limit 168,911,500 lekë (pa tvsh Firma fituese bashkimi i operatoreve ekonomikë A...& D..., vlera kontratës 167,054,321 leke pa tvsh, diferenca nga fondi limit 1,857,179 lekë

Nga auditimi rezulton:

Në DST të hartuara nga autoriteti kontraktor, në kriteret e veçanta për kualifikim “Licenca”, është kërkuar “ Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender duhet të kenë në stafin e tyre: Restaurator për monumentet e të trashëgimisë së arkitekturës të pajisur me licencë në R.P. me pikat A/2, A/3, A/4.

Vendosja e këtij kriteri, nuk është i mbështetur ligjërisht dhe është praktikisht i pa zbatueshëm, ka sjellë si rrjedhojë që padrejtësisht të mos vlerësohen operatorët ekonomikë që nuk plotësojnë këtë kriter.

-Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “Sistemim asfaltim i sheshit te Axhensisë (faza II)” Kavajë, kontrata datë 2014 lekë, me vlerë 3,148,340 lekë Fitues operatori “D... - 1”.Edhe pse 2 operatorët ekonomikë janë tërhequr nga lidhja e kontratës,ndërkohë nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertës në vlerën prej 563,068 lekë (Më hollësisht trajtuar në proces verbalin nr. 29, datë 14.05.2015)

-Në Tenderin me objekt “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”,(Tender i anuluar). Njoftimi i fituesit datë 20.06.2014. Titullari me shkresën nr.727/4, datë 19.08.2014, ka anuluar tenderin pasi operatori ekonomik i shpallur fitues nuk arriti të paraqitet brenda afatit ligjor për nënshkrimin e kontratës. Ndërkohë Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar konfiskimin e garancisë së ofertës operatorit ekonomik “S... CO” në vlerën 90,860 lekë, dëm ekonomik (Më hollësisht trajtuar në proces verbalin nr. 29, datë 14.05.2015)

1.E. A, me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Prokurimeve,

2.M. D, juriste në njësinë e prokurimit

Për shkeljet e mëposhtme:

Për periudhën e viteve 2013-2014 nga ana e Bashkisë Kavajë, janë kryer blerje të vogla në 144 raste në vlerën prej 24,064,031 leke, nga të cilat vlera prej 17,577,527 lekë, janë likuiduar, ndërsa vlera prej 6,486,504 lekë, ende deri më datën 31.12.2014 për mungesë fondesh nuk ishin likuiduar.

Blerjet janë kryer respektivisht për vitin 2013- në 42 raste në vlerën prej 13,468,560 lekë dhe vitin 2014 në 102 raste në vlerën prej 10,595,471 lekë.

Edhe pse për të 2 vitet 2013 dhe 2014 janë dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, Regjistrat e parashikimit dhe regjistrat e realizimit faktik, por në këto Regjistra nuk janë përfshirë edhe vlera e blerjeve në vlera të vogla për 144 raste në vlerën prej 24,064,031 leke, në kundërshtim me:

a. VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreun e VI-të “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Prokurimet me vlerë të vogël”, shkronja (a).

b. Udhëzimin e KM nr.01, datë 01.02.2013 “Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla” Pika 4 përcaktohet se: Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasisë dhe llojet e mallrave.

Mbi mos pasqyrimin në regjistrin e Parashikimit dhe realizimit të dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik të 2 procedurave për pastrimin e qytetit në vitet 2013-2014.

Për të 2 vitet 2013-2014 për pastrimin e qytetit me procedurën “Negocim pa shpallje paraprake” me operatorin ekonomik “K...” shpk janë lidhur **6 kontrata** në vlerën gjithsejt prej 22,658,317 lekë, pa tvsh, respektivisht:

a) Për vitin 2013, është lidhur kontratë për shërbimin e pastrimit të qytetit në vlerën prej 8,496,501 lekë, respektivisht:

-Kontrata e datës 31.05.2013 me vlerë 3,754,654 lekë pa tvsh, është lidhur për 3 muaj, por me kushtin “Kontrata do të priset menjëherë para këtij afati në rast të lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të dale fitues nga procedura normale e prokurimit publik. Afati i kësaj kontrate do të zgjasë edhe pas përfundimit të afatit 3 muaj, deri në lidhjen e kontratës së shërbimit me procedure prokurimi në kushtet normale.”

Duke qene procedura e hapur me të njëjtin objekt nuk përfundoi sipas afateve të parashikuara, Bashkia Kavajë ka lidhur gjate kësaj periudhe kontratën date 30.08.2013 me vlere 4,741,847 leke pa tvsh.

b) Për vitin 2014, janë zhvilluar 2 procedura tenderi me objekt “Shërbimi i pastrimit të qytetit” me procedure të hapur. Gjate kësaj periudhe është proceduar me kontrata 3-mujore po përsëri me operatorin ekonomik “K...” në vlerën e përgjithshme prej 14,161,816 lekë.

Edhe pse për të 2 vitet 2013-2014 për pastrimin e qytetit me procedurën “Negocim pa shpallje paraprake” me operatorin ekonomik “K...” shpk janë lidhur 6 kontrata në vlerën gjithsejt prej 22,658,317 lekë, pa tvsh, në asnjë vit këto fonde nuk janë dërguar në APP për tu botuar në regjistrin e parashikimeve dhe realizimin e prokurimeve, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu I- Organizimi i prokurimit publik, pika 3 Buletini i Njoftimeve Publike, -Shkronja b) Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik .

G. PROPOZIM PËR SHKARKIM NGA DETYRA

Bazuar në neni 42, germa “a”, nenin në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, dhe në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013 “Për planifikimin e territorit”, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, i propozojmë Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, fillimin e procedurave ligjore **për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Elvis Rroshi.**

Shkaqet e paraqitjes së kërkesës për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Njesisë së Qeverisjes Vendore, Bashkia Kavajë, paraqiten si më poshtë:

- Për mos ngritjen e Këshillit Teknik, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 *“Për planifikimin e territorit”* dhe nenin 45, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të territorit”*.
- Për mos funksionimin e Regjistrimit të Planifikimit të Territorit, veprim në papajtueshmëri me nenin 51, 52, 53, 56, 57 dhe 58, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit”* dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 *“Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrimit të planifikimit të territorit”*.
- Për miratimin në 12 raste, të strukturës ndërtimore për objekte private, duke mos zbatuar distancat nga kufiri i pronës, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 e 3 të nenit 70/33/1, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, si dhe me shkronjën “e” neni 3, shkronja “ll” pika 3 të nenit 39 dhe shkronja “a” pika 8 të nenit 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e Rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”*, të ndryshuar.
- Për miratimin në 20 raste, të lejeve zhvillimore të ndërtimit për punime në infrastrukturë pa plotësuar mw parw dokumentacionin përkatës teknik e ligjor, veprim në papajtueshmëri me nenin 70/1 dhe pikën 1, 2, 3, të nenit 70/14, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 *“Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar, si dhe me nenin 14 e 19, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e Rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”*, të ndryshuar.

Nga Bashkia Kavajë, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Niko Nako, Besim Bileri, Besmir Pajaj, Qemal Shehu, Jonild Hoxhaj dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT